

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6028
E enjte, 4 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Statistikat e Covid-19
në Kosovë: 1 142 raste
pozitive, 871 të shëruar
dhe 30 të vdekur | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AVDULLAH HOTI, KRYEMINISTRI I DYTË I KËSAJ LEGJISLATURE



Deputetët e Kuvendit të Kosovës për herë të parë në historinë e Kosovës e kanë votuar një qeveri pa fituesin e zgjedhjeve. Me 61 vota për, 24 kundër dhe një abstenim, deputetët e Kuvendit e kanë

zgjedhur Qeverinë e re të Kosovës e cila do të drejtohet nga kryeministri Avdullah Hoti. Qeveria e re është kundërshtuar nga Lëvizja Vetëvendosje, PDK-ja dhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, e

cila, në shenjë pakënaqësie, nuk e ka drejtuar këtë seancë. ShBA-ja, BE-ja, presidenti Thaçi, kancelari austriak dhe liderët shqiptarë e kanë përshëndetur formimin e qeverisë së re | FAQE 4-5

QEVERIA KURTI NDAU EDHE 12 MILIONË EURO PËR PAKON EMERGJENTE FISKALE



Në mbledhjen e fundit të qeverisë të udhëhequr nga Albin Kurti është marrë vendim për ndarjen e 12 milionë eurove për pakon emergjente fiskale. Po në këtë mbledhje është marrë vendim që të mbulohen shpenzimet e Kartonit të Gjelbër për

diasporën që vjen në vendin tonë. Kabineti qeveritar në mbledhjen e fundit ka marrë edhe vendime të tjera, mes të tjerash edhe për shkarkimin e bordit të drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Mitrovica" | FAQE 8-9

OPINION

MJEGULLA KOSOVË -
SHQIPËRI DHE NJERËZIT E
MIRË TË LUFTËS | F. 10-11

Bedri
ISLAMI



ALEANCAT SERBE DHE
OPORTUNIZMI EVROPIAN | F. 11

Prof. Agim
ZOGAJ



AKTUALE

KRU 'PRISHTINA': S'KA FRYRJE
TË FATURAVE DHE AS NGRITJE
TË ÇMIMIT TË UJIT | F. 5

EKONOMI



KPMM-ja DO TË DALË ME
RAPORT RRETH AKSIDENTIT
TRAGJIK NË MINIERËN E
ARTANËS | F. 9

EUROSTAT: KOSOVA KA
ÇMIMET MË TË ULËTA TË
RRYMËS NË EVROPË | F. 8

SPORT

FINALISTI I KUPËS
VENDOSËT NË DRENAS | F. 18

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

'Shpërthen' koronavirusi në Maqedoni, katër të vdekur dhe 101 raste të reja në 24 orët e fundit

MAQEDONI, 3 QERSHOR - Shifrat e fundit, siç kanë thënë mediat vendëse, praktikisht e kthejnë Maqedoninë e Veriut në situatën që shënonte me koronavirusin në fillim të prillit. Nga 974 teste të kryera gjatë 24 orëve të fundit, 101 persona kanë rezultuar pozitivë. Më shumë se gjysma janë regjistruar në Shkup, e 12 në Kumanovë dhe rrethinë. Janë konfirmuar edhe persona të vdekur, të moshave nga 58

deri në 84 vjeç. Komisioni i Sëmundjeve Infektive të enjten do të diskutojë për gjendjen pas shtimit të rasteve me Covid-19 dhe nuk e përjashton mundësinë e paraqitjes së propozimit në qeveri për aplikimin e masave kufizuese, sidomos gjatë fundjavës kur besimtarët ortodoksë shënojnë një festë fetare. Megjithatë, ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe,

pretendon se virusi për momentin nuk e ka fuqinë e njëjtë si në fillim të pandemisë dhe se të gjithë të infektuarit janë në gjendje të qëndrueshme. Ai ka theksuar se numri i lartë i rasteve është edhe rezultat i numrit të lartë të testeve që po kryhen në Maqedoninë e Veriut. Që nga fillimi i pandemisë në vendin fqinj kanë humbur jetën prej saj 145 persona, ndërsa të infektuar janë gati 2 500.



Hyn në fuqi Ligji për heqjen e taksës për pensionistët shqiptarë



TIRANË, 3 QERSHOR - Ka hyrë në fuqi Ligji për heqjen e taksës për personat që janë pensionistë, por pensionin e marrin në një shtet tjetër jashtë territorit të Shqipërisë. Shqiptarët të cilët kanë të drejtë ose përfitojnë pension në një vend tjetër, por edhe shtetasit e Bashkimit Evropian të cilët janë me leje qëndrimi në vendin tonë dhe të gjithë shtetasit e tjerë të huaj që kanë marrë nënshpëtimin shqiptarë dhe janë rezidentë, nuk do të paguajnë

më 15 për qind të vlerës së pensionit të tyre si tatim mbi të ardhurat personale. Deri para hyrjes në fuqi të këtij akti Shqipëria ka taksuar pensionistët edhe në rastet kur ata merrnin pension të huaj. Një normë ligjore kjo e cila ka pasur shumë diskutime nga ana fiskale për shkak të argumenteve nëse duhet të tatonet apo jo një e ardhur që merret nga taksat që janë paguar gjatë viteve të punës, kjo edhe për taksat për sigurime

shoqërore që janë paguar në një vend tjetër. Ka qenë propozim i ministrit të Shtetit për Diasporën në muajin janar që ka arritur që ta ndryshojë ligjin, duke argumentuar se pjesa e tatimit nuk ka pse paguhet në momentin që të ardhurat e pensionit shpenzohen në Shqipëri. Nga kjo nismë mendohet se do të përfitojnë qindra pensionistë shqiptarë të cilët kanë siguruar një pension jashtë vendit nga emigracioni dhe sot jetojnë në Shqipëri.

Ahmetaj: Në Shijak nisin pagesat për riparimet e tërmetit

TIRANË, 3 QERSHOR - Bashkia e Shijakut të premten do të nisë t'i japë dëmshpërblimet në formë grantesh për 1 174 familje që janë dëmtuar nga tërmeti në banesa individuale dhe për banorët e 27 pallateve në këtë zonë, shtëpitë e të cilëve kanë pësuar dëmtime, por pa pasur nevojë t'u prishen. Këshilli i Ministrave e ka miratuar vendimin, i cili i hap rrugë hedhjes së fondit me vlerë 5.1 milionë dollarë

për këtë bashki, proces i cili do të ndiqet për të gjitha njësitë e tjera vendore sapo ato t'i dorëzojnë listat. Ministri i Shtetit për Rindërtimin, Arben Ahmetaj, ka thënë se pagesa do të jepet dhe banorët me ato para do të bëjnë vetë riparimin e dëmeve. Qeveria ka kaluar edhe miratimin e marrëveshjes me Qeverinë e Turqisë për ndërtimin e 500 shtëpive në zonën e Laçit.

Projekti është gati, ka thënë ministri Arben Ahmetaj, pasi ka kaluar me shpejtësi të gjitha proceset, bashkë me atë të shpronësimit përgjatë kësaj zone. Po ashtu, qeveria i ka hapur rrugë rindërtimit të zonës në Parkun Arkeologji të Durrësit dhe detajimit të procesit të miratimit të lejeve të përsheptuara të ndërtimit për çdo objekt që do të rindërtohet pas goditjes nga tërmeti.



Rreth 11 për qind e adoleshentëve në Shqipëri e konsumojnë duhanin



TIRANË, 3 QERSHOR (ER) - Pavarësisht prej disa nismave ligjore dhe politikave fiskale që synojnë ta shkurtojnë pirjen e duhanit në Shqipëri, ky fenomen vijon të mbetet ende shqetësues. Situata mbetet në të njëjtat shifra, pa shënuar asnjë përmirësim. Ekspertët kanë thënë se në përgjithësi politikat

e institucioneve shtetërore, por edhe ato të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) për shkurtrimin e pirjes së duhanit, kanë dështuar. Një tjetër problem shqetësues vijon të mbetet edhe duhanpirja nga adoleshentët. Rreth 11 për qind e tyre në vendin tonë e konsumojnë këtë produkt. Një

shifër kjo që është e njëjtë me vendet e Ballkanit, por më e ulët se vendet e Evropës. Ekspertët kanë shprehur se tregtimi i duhanit në mënyrë të paligjshme dhe me çmim shumë të ulët favorizon blerjen e këtij produkti nga shtresa me ekonomi të ulët, por edhe nga fëmijët.

Rrethi i ri i dialogut, ndoshta në këtë muaj



Bashkimi Evropian (BE) është i interesuar që sa më shpejt të rifillojë dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë. Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, synon që ta zhvillojë shumë shpejt rrethin e parë të negociatave, ndoshta këtë muaj. Sipas burimeve diplomatike të REL-it, Lajçaku ka thënë se do të kontaktojë me Qeverinë e re të Kosovës në mënyrë që të përgatitet takimi, i cili do ta shënonte edhe rifillimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajçak, synon që ta zhvillojë shumë shpejt rrethin e parë të bisedimeve, ndoshta edhe këtë muaj, ka marrë vesh Radio Evropa e Lirë nga burime të besueshme. Lajçaku ka folur të martën para ambasadorëve të vendeve anëtare të BE-së në Komitetin për Politikë dhe Siguri në Bruksel. Për qëllimet e tij, kanë thënë burimet diplomatike, ai e ka marrë mbështetjen e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. "Mirënjohës për mbështetjen e

fortë që mora nga 27 shtetet anëtare të BE-së sot. Diskutim shumë inkurajues për mandatin tim dhe rrugën përpara", ka shkruar Lajçak në llogarinë e vet në "Twitter". Lajçaku ka thënë se do të kontaktojë edhe me Qeverinë e re të Kosovës në mënyrë që të përgatitet takimi që do ta shënonte edhe rifillimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Kujtojmë se Kuvendi i Kosovës të mërkurën ka zgjedhur qeverinë e re, në krye me Avdullah Hotin, i cili është shprehur i gatshëm për vazhdimin e dialogut me Serbinë.

Burimet diplomatike në Bruksel kanë thënë se Lajçaku në disa raste ka përsëritur se ndryshimi i kufijve dhe shkëmbimi i territoreve nuk mund të jenë rezultat i dialogut.

Kjo ide është shpërfaqur si mundësi për normalizimin e marrëdhënieve nga vetë presidentët e Kosovës dhe Serbisë, por ka hasur në reagime për dhe kundër. Në takimin e së martës në Bruksel, shumica e shteteve anëtare të BE-së raportohet se janë shprehur kundër kësaj ideje.

Javën e kaluar edhe përfaqësuesi i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka thënë se idetë e tilla nuk kanë mbështetje dhe se BE-ja do të preferonte që të mbahet gjendja e tanishme e kufijve. Burimet diplomatike kanë thënë se në takimin e Komitetin për Politikë dhe Siguri në Bruksel është kritikuar edhe qasja e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ndaj emërimit të Lajçakut në postin e përfaqësuesit të posaçëm, e sidomos deklaratat e tij se ai nuk do të marrë pjesë në dialogun që udhëhiqet nga ish-kryediplomati sllovak. Presidenti i Kosovës, Hashim

Thaçi, në disa raste ka insistuar në rolin udhëheqës të Shteteve të Bashkuara (ShBA) në dialog. Dialogu Kosovë - Serbi, i cili ka nisur qysh në vitin 2011 me ndërmjetësimin e BE-së, është ndërprerë në fund të vitit 2018

për shkak të një takse që u ka vënë Qeveria e atëhershme e Kosovës prodhimeve të importuara nga Serbia. Përfaqësuesi i posaçëm në dialog tani ka edhe ShBA-ja, diplomatit Richard Grenell.

Vuçiqi nuk e përjashton mundësinë e rifillimit të dialogut

Serbia humbet një milion euro në ditë për shkak të masave tregtare të Prishtinës, ka thënë presidenti serb Aleksandër Vuçiq. "Ne do të shohim se çfarë do të bëjë qeveria e re, nëse do t'i heqë ato masa", ka thënë Vuçiqi në një vizitë në Novi Pazar. I pyetur nëse është e mundshme që dialogu midis Beogradit dhe Prishtinës të vazhdojë në fund të qershorit, Vuçiqi u përgjigj se kjo është e mundur nëse autoritetet në Prishtinë heqin kufizimet për lëvizjen e mallrave dhe

njerëzve nga Serbia. Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është ndërprerë në fund të vitit 2018, pasi qeveria e ish-kryeministrit Ramush Haradinaj vendosi tarifën 100 për qind për mallrat e Serbisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës. Më pas, qeveria e drejtuar nga ish-kryeministri Albin Kurti e shfuqizoi vendimin për tarifën, duke e zëvendësuar atë me masat e reciprocitetit ndaj Serbisë. Heqjen e masës së reciprocitetit e kanë kërkuar Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS KA VOTUAR QEVERINË E RE

AVDULLAH HOTI, KRYEMINISTRI

Deputetët e Kuvendit të Kosovës për herë të parë në historinë e Kosovës e kanë votuar një qeveri e cila nuk e përfshinë fituesin e zgjedhjeve. Me 61 vota për, 24 kundër dhe një abstenim, deputetët e Kuvendit e kanë zgjedhur Qeverinë e re të Kosovës, e cila do të drejtohet nga kryeministri Avdullah Hoti. Qeveria e re është kundërshtuar nga Lëvizja Vetëvendosje, PDK-ja dhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, e cila, në shenjë pakënaqësie, nuk e ka drejtuar këtë seancë. ShBA-ja, BE-ja, presidenti Thaçi, kancelari austriak dhe liderët shqiptarë e kanë përshëndetur formimin e qeverisë së re

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Legjislatura e Shtatë e Kuvendit të Kosovës ka votuar të mërkurën qeverinë e dytë brenda këtij mandati. Me 61 vota për, 24 kundër dhe një abstenim, deputetët e kanë zgjedhur Qeverinë e re të Kosovës të drejtuar nga Avdullah Hoti i LDK-së. Kundër kësaj qeverie ka votuar PDK-ja, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje, e cila është parti më e madhe në këtë mandat, nuk ka marrë pjesë në seancë.

Seanca e votimit të qeverisë ka shkuar në mënyrë të qetë dhe nuk ka zgjatuar shumë, ndonëse gjatë mbajtjes së saj disa qytetarë kanë protestuar afër ndërtesës së Kuvendit. Fillimisht, i mandatuari për kryeministër të Kosovës, Avdullah Hoti, ka prezantuar planin e tij qeverisës, duke treguar prioritetet. Ai ka bërë me dije se qeveria e tij do të ketë dy prioritetet kryesore, luftimin e pandemisë Covid-19 dhe rimëkëmbjen ekonomike. "Krahas këtyre prioritetëve, do ta kemi forcimin e shtetit, luftimin e krimit dhe korrupsionit, rritjen e punësimit, marrjen e përgjegjësisë kushtetuese për ta çuar përpara dialogun me Serbinë, duke ruajtur integritetin territorial", ka deklaruar Hoti.

Sa i takon rimëkëmbjen ekonomike, Hoti ka deklaruar se do të krijohet fondi për rimëkëmbje ekonomike pasi, sipas tij, dëmet nga pandemia e koronavirusit të ri mund të jenë të paparashikueshme. Ndër të tjera, ai është zotuar për mbështetje për bizneset për ta tejkaluar krizën ekonomike që ka shkaktuar pandemia.

Në ekspozenë e tij të gjatë para deputetëve, ai ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi. "Autoritetet e Kosovës do ta respektojnë

Kushtetutën e Kosovës gjatë këtyre bisedimeve. Dialogu do të bazohet në objektiva të qarta që duhet të arrihet nga kjo marrëveshje përfundimtare, pastaj për çështje që duhet të dialogohen si dhe raportimi dhe transparencja gjatë këtij procesi", ka deklaruar Hoti. Ai ka vlerësuar se në këtë fazë është shumë i rëndësishëm përmirësimi i raporteve me partnerët strategjikë të Kosovës, veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Ne nuk kemi dilema të llojit me Amerikën apo me dikë tjetër. Për ne partneriteti me ShBA-në nuk ka alternativë. Prandaj ne do ta kthejmë zotimin tonë 30-vjeçar që raportet tona me ShBA-në janë raporte të një miqësie speciale dhe të përhershme", ka theksuar Hoti. Në ekspozenë e prezantuar, Hoti ka folur edhe për reforma në ekonomi, arsim, shëndetësi, siguri dhe drejtësi. Më pas, deputetët e koalicionit qeverisës i kanë dhënë mbështetje qeverisë së re.

Shef i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se kjo qeveri nuk duhet t'i shkarkojë bordet që janë emëruar nga qeveria Kurti. "Unë i rekomandoj qeverisë që bordet e caktuara nga LV-ja të mos shkarkohen fillimisht, por t'u bëhet një performancë e

thukët dhe të vlerësohet puna e tyre, jo të shkarkohen pse u bënë nga LV-ja, por të shihet baza e tyre juridike dhe ligjore", ka thënë Gashi.

Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Teuta Haxhiu, ka thënë se prioriteti i qeverisë Hoti duhet të jetë zhvillimi ekonomik. "Kemi vendosur që të jemi pjesë e kësaj qeverie, me besimin se gjërat do të lëvizin më mirë. Në orientimin bazik për rimëkëmbjen ekonomike. Kjo do të thotë se po i marrim përgjegjësitë e tona si partnerë", ka thënë ajo, duke shtuar se kjo qeveri duhet të ketë kujdes në disa tema. E në

emër të koalicionit Nisma - AKR në Kuvend ka folur Endri Shala, i cili i ka dhënë mbështetje qeverisë së re.

LV-ja, PDK-ja dhe Vjosa Osmani kundër qeverisë së re

Lëvizja Vetëvendosje, partia fituese e zgjedhjeve të fundit, e ka kundërshtuar formimin e qeverisë së re, me mospjesëmarrje në seancë. Pas ekspozesë së Avdullah Hotit, shefi i grupit të LV-së, Rexhep Selimi, ka hyrë në sall për ta treguar qëndrimin e kësaj partie. Ai ka thënë se kjo qeveri

është ilegale dhe ilegjitime. "Qeveria që doni ta formoni është edhe ilegale edhe ilegjitime. Është ilegale se vjen pas shkeljeve të njëpasnjëshme të Kushtetutës së Kosovës siç është dekreti jokushtetues për mandatin e humbësit të zgjedhjeve për kryeministër e deri tek aktgjykimi i padrejtë dhe jokushtetues i Gjykatës Kushtetuese", ka deklaruar Selimi. Sipas tij, kjo qeveri është më shumë se qeveria "Thaçi 3". "Kjo qeveri do t'i duhet atij vetëm sa për t'i shërbyer për legjitimin e ndarjes së Kosovës dhe të përfitojë nga kjo qeveri edhe një mandat tjetër si president", është shprehur Selimi, duke shtuar se po tentohet të bëhet një qeveri që do ta kthejë shtetin në duart e grupeve e të individëve. "Ju qëllimet i keni të cekëta, por të rrezikshme. Të thjeshta, por të këqija", ka thënë Selimi.

Në emër të PDK-së, qeverinë e re e ka kundërshtuar lideri i saj, Kadri Veseli. Ai ka thënë se Kosova në këtë situatë ka ardhur nga mashtrimet e bëra të partive politike, LV-ja dhe LDK-ja. "Ideja e përfutimit me çdo kusht, çdo herë sjell humbjen pa kusht. Kjo po i ndodh edhe sot Albin Kurtit.

Liderët e koalicionit mbështesin qeverinë e re

Udhëheqësit e koalicionit qeverisës kanë mirëpritur votimin e qeverisë së re. Edhe pse nuk do të kenë ndonjë post në këtë qeveri, ata kanë thënë se këtë qeveri e presin punë të mëdha. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se kjo ishte një ditë e madhe për Kosovën. "Urime qytetarë të Republikës së Kosovës! Urime LDK, AAK, Nisma, AKR, parti

parlamentare që përfaqësoni komunitetet joshumicë! Urime deputetë që votuat pa hezituar dhe pa u frikësuar! Vota juaj do ta shpëtojë Kosovën", ka shkruar Mustafa në profilin e vet në "Facebook".

Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka përshëndetur votimin e qeverisë së re, duke thënë se atë e presin punë të mëdha. Kurse lideri i Nismës,

Fatmir Limaj, ka deklaruar se Kosova ka nevojë për një qeveri e cila e kthen stabilitetin në vend.

"Si Nismë Socialdemokrate zotohemi se do ta japim kontributin tonë në qeveri dhe Kuvend gjatë këtij mandati qeverisës, për zbatimin e programit qeverisës të harmonizuar mes partnerëve të koalicionit", ka thënë Limaj.

I DYTË I KËSAJ LEGJISLATURE



Presidenti Thaçi fton Kurtin që t'ia dorëzojë detyrën Hotit

Pas votimit të qeverisë së re, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar nga kryeministri i deritanishëm, Albin Kurti, që ta bëjë dorëzimin e detyrës së kryeministrit të Avdullah Hoti. Në një konferencë për medie, Thaçi ka thënë se Kurti duhet të heqë dorë nga uzurpimi i zyrave të qeverisë. "Gjithashtu, kërkohet që Kurti të heqë dorë nga barrikadimi

në zyrën e uzurpuar. Barrikadimi i tij që nuk i bën nder as atij e as partisë së tij, as shtetit të Kosovës, as demokracisë në Kosovë. Pas shkarkimit, ai tanimë po bëhet edhe më qesharak", ka deklaruar Thaçi.

Duke folur për qeverinë e re, presidenti Thaçi ka thënë se e mirëpret zotimin e kryeministrit Avdullah Hoti për ndërtimin e marrëdhënieve

speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Konferenca e presidentit Thaçi është penguar nga brohoritjet e një grupi qytetarësh që ishin tubuar në sheshin para objektit të Kuvendit të Kosovës, e të cilët kundërshtojnë formimin e qeverisë së re dhe kërkonin zgjedhje të reja. Ata për një moment kanë tentuar të hyjnë në Kuvend, mirëpo janë penguar nga policia.

Osmani.

Ajo nuk ka treguar nëse do të vazhdojë ta mbajë pozitën e kryetares së Kuvendit të Kosovës.

Drejtimin e seancës e ka bërë nënkryetari i Kuvendit nga radhët e LDK-së, Kujtim Shala, pasi ishte autorizuar nga kryeparlamentarja.

ShBA-ja dhe BE-ja mirëpresin formimin e qeverisë

Pas votimit të qeverisë së re në Kuvend, ShBA-ja dhe BE-ja e kanë përshëndetur një veprim të tillë, duke ia kujtuar qeverisë prioritetet. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka thënë se mezi pret të punojë me qeverinë Hoti për ta vazhduar punën e rëndësishme për paqen, drejtësinë, forcimin e marrëdhënieve rajonale dhe luftimin kundër Covid-19.

Edhe i dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, e ka mirëpritur votimin e Qeverisë së re të Kosovës. "Ne e mirëpresim formimin e qeverisë së re dhe mezi presim të bashkëpunojmë për vazhdimin e dialogut me Serbinë", është thënë në

deklaratën e zyrtarit të lartë amerikan. Kurse BE-ja ka vlerësuar se pandemia e koronavirusit do të mbetet një sfidë e përbashkët për të ardhmen e parashikueshme dhe BE-ja do të vazhdojë të qëndrojë pranë Kosovës dhe njerëzve të saj. "Ne gjithashtu duam ta shohim Kosovën përpara në rrugën e saj evropiane. Kjo do të kërkojë përpjekje të vendosura për reforma për të forcuar sundimin e ligjit, veçanërisht luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe për ta promovuar zhvillimin socio-ekonomik", është thënë në deklaratën e Zyrës së BE-së në Prishtinë, duke shtuar se një rifillim i shpejtë i dialogut Beograd - Prishtinë, i lehtësuar nga BE-ja, është thelbësor për të arritur një normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Serbinë.

Për zgjedhjen në postin e kryeministrit, Avdullah Hoti ka marrë urime nga kancelari austriak Sebastian Kurz, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe liderë të tjerë shqiptarë.

Qeveria Kurti u rrëzua përmes një mocioni të mosbesimit në Kuvendin e Kosovës. Pas rrëzimit të qeverisë Kurti, presidenti Thaçi kërkoi një kandidat të ri nga Lëvizja Vetëvendosje, e që nuk ndodhi. Presidenti Thaçi, pas konsultimit me partitë politike nëse janë në favor të shkuarjes në zgjedhje apo zgjedhjes së një qeverie të re, mandatoi Avdullah Hotin e LDK-së kandidat për formimin e qeverisë së re. Dekreti i presidentit Thaçi përfundoi në Gjykatë Kushtetuese e cila vlerësoi se dekretimi i Avdullah Hotit ishte veprim kushtetues.

Kjo do t'i ndodhë edhe Avdullah Hotit, i cili është kopje joorigjinale e këtij mashtrimi. Do ta bëjë edhe më të rëndë situatën në vend", ka thënë Veseli.

Ai ka deklaruar se LDK-ja kur nuk ka qenë në pushtet ka ndihmuar rrënimin, ndërsa kur është në pushtet kurrë nuk merr përgjegjësitë që i takojnë. "Pastaj, këto koalicionet, qoftë ai paraprak, qoftë ky aktual, kur dëgjon fyerjet mes tyre dhe bashkimet më pas, nuk mund të mos pyesësh: A ka mbetur pak nder e moral te këta njerëz?", është shprehur Veseli, duke shtuar se Kosova ka nevojë t'i kthehet agjendës së

rimëkëmbjes nacionale.

Qeverinë Hoti e ka kundërshtuar edhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, e cila është nënkryetare e kuvendit. Pas përfundimit të seancës së Kuvendit të Kosovës, Osmani, duke folur për refuzimin e saj që ta drejtojë seancën, ka thënë se kjo qeveri nuk përfaqëson vullnetin qytetar. "Në radhë të parë një qeveri e cila në tërësi varet nga votat e Listës Serbe do të thotë nga Beogradi dhe së cilës votën e 61-të ia siguroi presidenti Thaçi në kundërshtim me rolin e tij kushtetues asnjëherë nuk mund të jetë përfaqësuese e vullnetit qytetar", ka deklaruar

Ky është kabineti qeveritar

Qeveria e re do t'i ketë 16 ministri dhe katër zëvendëskryeministra. Përbërja e kabinetit të ri qeveritar do të jetë kjo: Avdullah Hoti, kryeministër; Besnik Tahiri, zëvendëskryeministër i parë; Driton Selmanaj, zëvendëskryeministër; Albulena Bala-Halimi, zëvendëskryeministër; Goran Rakiq, zëvendëskryeministër dhe ministër i Pushtetit Lokal; Hykmete Bajrami, ministër e Financave; Besian Mustafa, ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Vlora Dumoshi, ministër e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Anton Çuni, ministër i Mbrojtjes; Arban Abrashi, ministër i

Infrastrukturës dhe Ambientit; Agim Veliu, ministër i Punëve të Brendshme; Armend Zemaj, ministër i Shëndetësisë; Blerim Kuçi, ministër i Zhvillimit Ekonomik; Selim Selimi, ministër i Drejtësisë; Meliza Haradinaj-Stublla, ministër e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Ramë Likaj, ministër i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Skënder Reçica, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale; Vesel Krasniqi, ministër i Tregtisë dhe Industrisë; Dalibor Jevtiq, ministër për Kthim dhe Komunitete; dhe Enis Kervan, ministër i Zhvillimit Rajonal.

Kurti: S'do ta bëj pranim-dorëzimin. Nuk e pranoj atë që e shkarkova

Ish-kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka folur në lidhje me votimin e qeverisë Hoti. Kurti ka bërë me dije se nuk do të ketë nesër pranim-dorëzim të detyrës së kryeministrit, duke thënë se nuk mund të pranojë t'ia dorëzojë detyrën një kryeministri të cilin e ka shkarkuar sa ishte zëvendës i tij. "Aktgjykimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese është i papranueshëm. Me atë vendim ata kanë bërë agresion mbi Kushtetutën e Republikës dhe kanë zhvlerësuar veten e tyre si Gjykatë. Kjo qeveri është

e paligjshme. Kjo është qeveria koti, ne jemi qeveria alternative. S'do ta bëj pranim-dorëzimin sepse s'mund të pranoj atë që e shkarkova, ndërkohë që edhe u dorëzua te presidenti. Ne vazhdojmë betejën. Do të kthehemi përsëri e shumë shpejt", ka thënë Kurti.

Zyra e kryeministrit të Kosovës nëpërmjet një njoftimi për medie ka treguar se sot (enjte) në orën 9:00 do të mbahet ceremonia e pranim-dorëzimit të detyrës së kryeministrit të ri, Avdullah Hoti.

Vazhdon mbështetja për fermerët e Kamenicës

KAMENICË, 3 QERSHOR (ER) - Komuna e Kamenicës, së bashku me Caritasin Zvicëran, kanë shpërndarë pjesën tjetër të materialeve nga granti për mbështetjen dhe promovimin e prodhimtarisë bujqësore në këtë komunë. 14 fermerë kanë përfituar nga ky grant komplet pakon nga fidanët, sistemin e ujitjes, sistemin mbështetës, rrethojat, plehun, materialin mbrojtës dhe mjetet e tjera përcjellëse.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron

Kastrati, ka falënderuar Caritasin për mbështetjen e vazhdueshme dhe Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për punën e palodhshme për t'u dalë në ndihmë fermerëve. "Nga vazhdimi i projektit me Caritasin, për t'u dalë në ndihmë fermerëve bëmë shpërndarjen e pjesës tjetër të materialeve për ta. Rrethojat për parcelat e tyre do t'u shërbejnë për sigurinë e kulturave bujqësore varësisht nga veprimtaria që kanë. Faleminderit stafit të

Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari e Zhvillim Rural për angazhim të vazhdueshëm në secilin proces", ka thënë Kastrati. Ndërsa drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Naim Arifi, tha se komuna dhe DBPZhR-ja do të jenë afër dhe në mbështetje të fermerëve dhe bujqve gjithmonë. "Falënderojmë Caritasin Zvicëran për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm! Komuna dhe DPBZhR-ja do t'i mbështesë gjithmonë fermerët e Kamenicës", ka thënë Arifi.



Jashari shpreh mirënjohje për punëtorët shëndetësorë në Skenderaj



SKENDERAJ, 3 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku si dhe drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Ibush Hetemi, kanë vizituar mantelbardhët të cilët janë duke qëndruar në vijën e parë të frontit tani gati tre muaj që kur është shfaqur rasti i parë me Covid-19 në Kosovë. Gjatë kësaj vizite kryetari Jashari ka shprehur mirënjohje për stafin mjekësor për punën e palodhshme që është duke bërë, duke qenë në gatishmëri

për t'u shërbyer me cilësi të lartë 24 orë qytetarëve të Skenderajt. Po gjatë këtij takimi, stafi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) ka njoftuar nga afër për të gjithë procesin e deritanishëm të menaxhimit të situatës si dhe për gjendjen aktuale në të cilën është Skenderaj. "Duke qenë se shëndetësia është prioritet i qeverisjes sime, në këtë vizitë premtova që përkrahja për stafin shëndetësor nuk do të mungojë asnjëherë si dhe puna për ta përmirësuar gjendjen e kësaj fushe nuk do të ndalet", ka thënë Jashari.

Jep dorëheqje nënkryetari i Ferizajt

FERIZAJ, 3 QERSHOR (ER) - Naim Ferati ka dhënë dorëheqje nga pozita e nënkryetarit të Komunës së Ferizajt. Lajmin e ka dhënë Komuna e Ferizajt nëpërmjet një njoftimi për media. "Numri dy i Ferizajt, Naim Ferati, i cili që nga viti 2007 mbajti poste publike në qeveritë lokale, dikur drejtor jashtëzakonisht i suksesshëm i Kulturës, Rinisë dhe Sportit e në qeverinë Aliu numri i dytë i saj, deklaroi sot dorëheqjen nga kjo pozitë, me qëllim të përkushtimit e avancimit të mëtejshëm profesional", ka njoftuar kjo komunë. Sipas këtij njoftimi, kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, ka falënderuar Feratin për bashkëpunimin e deritanishëm. "Falënderues për kohën e

shërbimit, qasjen kreative e efektive për menaxhimin me segmente e sektorë të administratës komunale ndaj tij, u shpreh i pari i Ferizajt, Agim Aliu. Ai tha se figura politike e nënkryetarit Ferati paraqet një vlerë të shtuar për politikën ferizajase. Më tutje, me falënderimin për punën e çmueshme të deritanishme, kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, i uroi suksese në rrugëtimin profesional nënkryetarit të deritanishëm, Naim Feratit. Nënkryetari i komunës, Naim Ferati, do t'i ushtrojë detyrat e domosdoshme deri në plotësimin e pozitës vakante që pritet të ndodhë në ditët në vijim", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.



Nga sot çerdhet publike të Gjilanit, të gatshme për pranimin e fëmijëve



GJILAN, 3 QERSHOR (ER) - Bazuar në rekomandimet e qeverisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për hapjen e çerdheve, Komuna e Gjilanit ka bërë të gjitha përgatitjet për rihapjen e çerdheve publike që nga sot (e enjte).

Drejtori i Arsimit, Nazim Gagica, ka njoftuar se për t'u siguruar rreth përgatitjeve për rihapjen e çerdheve, kanë kërkuar vlerësim profesional higjienik e sanitar nga Qendra Rajonale e Shëndetit Publik dhe inspektori sanitar në nivel regjional. "Pas vizitave të cilat janë realizuar sot në terren

nga QRShP dhe inspektori sanitar, të njëjtët rekomandojnë se çerdhet e komunës sonë kanë përmbytur të gjitha rekomandimet e dala nga udhëzuesi i MASHTI-it dhe janë të gatshme t'i mirëpresin fëmijët që nga nesër, respektivisht 04.06.2020", ka thënë Gagica.

Statistikat e përgjithshme të Covid-19 në Kosovë: 1 142 raste pozitive, 871 të shëruar dhe 30 të vdekur

Që nga rasti i parë me Covid-19 në Kosovë janë infektuar 1 142 qytetarë, prej tyre 871 janë shëruar dhe 30 kanë ndërruar jetë. Vetëm të mërkurën në Kosovë janë paraqitur 19 raste të reja me koronavirus. Me këtë rast, IKShPK-ja ka apeluar që të kihet kujdes për shkak se ende nuk ka kaluar rreziku i përhapjes së virusit Korona. “Vazhdoni ta mbani distancën fizike dhe mbajtjen e maskave. Lani duart me kujdes disa herë në ditë nga 20-30 sekonda”, ka njoftuar IKShPK-ja

PRISHTINË, 3 QERSHOR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar për 19 raste të reja me Covid-19 në 24 orët e fundit. Ky institut ka bërë me dije se janë shëruar edhe 14 persona të tjerë nga koronavirusi. “Sot, më 03 qershor 2020, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 253 mostra të marra nga Klinika Infektive dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren. Me SARS-CoV-2 janë konfirmuar 19 raste”, ka njoftuar IKShPK-ja. Sipas këtij njoftimi, rastet e raja me Covid-19 janë nga Vushtrria, Fushë-Kosova, Podujeva, Kamenica, Obiliqi dhe Mitrovica. “Rastet pozitive janë raste kontakti nga: komuna e Vushtrrisë 14 raste (sipas vendbanimeve: 5 raste në Vushtrri, 4 raste në Nadakocv, 4 raste në Stanovc i Poshtëm dhe 1 rast në Reznik), komuna e Fushë-Kosovës 1 rast (sipas vendbanimit: 1 rast në Miradi e Poshtme), Komuna e Obiliqit 1 rast (sipas vendbanimit 1 rast në Milloshevë), komuna e Podujevës 1 rast (sipas vendbanimit: 1 rast në Bellopojë), komuna e Kamenicës 1 rast (sipas vendbanimit: 1 rast në Rogoçicë) dhe 1 rast me vendbanim në Mitrovicë”, ka njoftuar IKShPK-ja. Më tutje, IKShPK-ja ka bërë me dije se numri i të shëruarave me Covid-19 ka arritur në 871, ndërsa numri i të infektuarave ka shkruar në 1 142 raste. Që nga rasti i parë me Covid-19 në Kosovë kanë vdekur 30 persona. “Sot, më 03 qershor 2020, janë shëruar 24 pacientë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 871 raste. Nga data 08 shkurt deri më 03 qershor 2020 në Laboratorin e Mikrobiologjisë

Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 15 586 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe prej tyre pozitive rezultojnë gjithsej 1 142 raste, me gjithsej 30 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Në IKShPK në vazhdimësi përgjatë 24 orëve janë duke u kontaktuar dhe mbikëqyrur të gjitha kontaktet e rasteve, si dhe kontaktet e kontakteve duke i obliguar për vetizolim dhe të kërkojnë ndihmë mjekësore nëse kanë simptoma. Në nivel global, nga data 31 dhjetor 2019 deri më 03 qershor 2020, sipas ‘Worldometers’, janë raportuar gjithsej 6 485 814 raste të Covid-19 dhe 383 164 raste të vdekjes”, ka njoftuar IKShPK-ja. Njëpërmjet këtij njoftimi IKShPK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve që të kenë kujdes për shkak se ende ekziston rreziku i përhapjes së Covid-19. “Të nderuar qytetarë! Çdo hap përpara që bëjmë bartë edhe rrezikun me vete derisa virusi është ende në mesin tonë. Vazhdoni ta mbani distancën fizike dhe mbajtjen e maskave. Lani duart me kujdes disa herë në ditë nga 20-30 sekonda. Lehtësimi i lëvizjes nuk nënkupton mosrespektimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Lehtësimi i masave është bërë për të na bërë më të përgjegjshëm. Ju lutem të keni kujdes sepse akoma ekziston rrezik i përhapjes në vendet ku ka grumbullim të madh të njerëzve. Luten institucionet për mbajtjen e rendit dhe inspektoratet për angazhim të shtuar gjatë ditëve në vijim. Ju faleminderit për mirëkuptim!”, ka njoftuar IKShPK-ja.



Stafi i MSh-së falënderon Vitinë: E mbrojtëm Kosovën nga kolapsi i shëndetit publik

PRISHTINË, 3 QERSHOR (ER) - Arben Vitia është larguar nga posti i ministrit të Shëndetësisë pas votimit të qeverisë Hoti. Stafi i Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) ka thënë se gjatë këtyre tre muajve të pandemisë kanë arritur ta mbrojnë Kosovën nga kolapsi i shëndetit publik. “Deri këtu arritëm së bashku. Me shumicën që ndih-

muan dhe punuan. Mësuam e pësuam shumë, por e mbrojtëm Kosovën nga kolapsi i shëndetit publik. Ne ia dolëm sepse nuk vendosëm theksin te ndëshkimi apo zënia në gabim, por te solidariteti. Dhe kësaj kërkese, me gjithë vështirësitë apo incertitë e zakoneve të dashura të jetës sonë familjare e kolektive, iu përgjigj me

mirëkuptim shumica dërrmuese e qytetarëve të Republikës. Erdhëm së bashku deri këtu, me besimin e ndërsjellë. Këta tre muaj shënojnë një stad të ri për vendin. Sakrifikuam shumë që të mos gjunjëzoheshim dhe ia dolëm. Në këmbë dhe solidarë”, është thënë në njoftimin e MSh-së.



KPMM-ja do të dalë me raport rreth aksidentit tragjik në minierën e Artanës

PRISHTINË, 3 QERSHOR (ER) - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), pasi ka ngushëlluar familjen e inxhinierit të xehetarisë Haki Arifi dhe minatorit Idriz Gërbeshi, si dhe të gjithë minatorët e Trepçës, ka theksuar se me dhimbje të madhe ka njoftuar opinionin publik lidhur me fatkeqësinë e cila ka ndodhur të martën.

KPMM-ja ka njoftuar se aksidenti me fatalitet në minierën e Artanës ka ndodhur të martën rreth orës 10:25. "Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është njoftuar nga drejtori i njësisë biznesore të Minierave me flotacion Kishnicë-Artanë përmes telefonit në orën 10:34h. Kryeinspektori i Inspektoratit të Minierave të KPMM-së menjëherë ka njoftuar të gjitha organet e sigurisë së vendit dhe Departamentin e Emergjencave Civile. Një ekip i inspektoratit të KPMM-së menjëherë është nisur për vendin e ngjarjes. Meqenëse Bordi i KPMM-së po atë ditë kishte për ta mbrojtur raportin e punës për vitin 2019 në Komisionin për Zhvillim Ekonomik të Kuvendit të Kosovës në orën 11:00h, kryesuesi i bordit të KPMM-së njoftoi për këtë deputetët e këtij Komisioni të Kuvendit të Republikës së Kosovës", ka njoftuar KPMM-ja. Sipas këtij njoftimi, kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Endrit Shala, ka kërkuar nga deputetët të shtyhet për një afat tjetër raportimi i KPMM-së në Kuvend për shkak të kësaj situate të krijuar dhe ky propozim është mbështetur nga të gjithë deputetët e pranishëm të këtij komisioni. "Menjëherë pas ndërprerjes së mbledhjes, bordi i KPMM-së u nis për në minierën e



Artanës. Lidhur me aksidentin, ngjarja ka ndodhur si pasojë e shembjes së shkëmbinjve në korridorin kryesor të nënkatit 798-24 të horizontit të IV-të të minierës së Artanës, respektivisht në zonën ndërmjet korridorit nr. 9 dhe oxhakut të xehes nr. 2. Shembja ka ndodhur nga pjesa tavanore e shkëmbinjve gëlqerorë të mërmëritur, të përzier me xehe. Në vendin e shembjes në atë moment janë ndodhur inxhinieri i xehetarisë Haki Arifi, i lindur më 1969 dhe minatori, xehetari i kualifikuar Idriz Gërbeshi, i lindur më 1967. Kurse në afërsi të vendit të aksidentit ishin edhe një numër i caktuar i minatorëve, të cilët, fatmirësisht, kanë shpëtuar nga aksidenti. Fatkeqësisht që të dy punëtorët janë goditur, e më pas mbuluar nga masat shkëmbore të shembura, me ç'rast kanë humbur jetën në vendin e ngjarjes", është thënë në njoftim, duke shtuar se, falë institucioneve të sigurisë, është arritur të nxirren nga miniera

Arifi e Gërbeshi. "Pas informatës në minierë kanë arritur përfaqësues nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik i Kuvendit të Kosovës, kryeministri, ministra dhe deputetët të Kuvendit të Kosovës, si dhe Departamenti i Emergjencave Civile të Kosovës, FSK-ja, policia, prokuroria, mjekësia ligjore etj. Qeta e shpëtimit e Artanës ka qenë në gjendje gatishmërie. Në ndihmë ka ardhur edhe qeta e shpëtimit e Stantërgut, një njësi zjarrfikësish nga KEK-u si dhe një njësi zjarrfikësish nga Komuna e Artanës. Pas ekzaminimit të vendit të aksidentit, nga njësitë e Fornezikës dhe Inspektoratit të Minierave, rreth orës 15:30h kanë hyrë në minierë qetat e shpëtimit të Artanës, Stan Tërgut dhe një ekip i FSK-së. Këto ekipe, nën kushte të limituara të punës në minierë, arritën që t'i zhblokojnë dhe nxjerrin trupat e viktimave të këtij aksidenti rreth orës 00:30h të datës 03.06.2020, pra pas mesnatës dhe i kanë dorëzuar tek

ekipet e mjekësisë ligjore të QKUK-së", është thënë në këtë njoftim.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM-ja ka bërë me dije se ka ngritur një komision nga Inspektorati i Minierave, i cili në ditët në vijim

e ka për detyrë ta inspektojë vendin e ngjarjes dhe të dalë me raport për shkaqet e këtij aksidenti. "Si përfundim, të gjithë së bashku të lutemi që mos të ndodhin aksidente të tilla në të ardhmen", ka njoftuar KPMM-ja.

OEAK-u ndan nga 1 000 euro për familjet e dy minatorëve që humbën jetën në Artanë

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka bërë me dije se ka ndarë nga 1 000 euro për familjet e dy minatorëve të cilët kanë humbur jetën në minierën e Artanës. OEAK-u ka shprehur keqardhjen dhe ngushëllimet më të sinqerta për aksidentin, i cili ka lënë të vdekur në vendin e punës dy punëtorët të kësaj miniere, inxhinierin Haki Arifi dhe xehetarin Idriz Gërbeshi. "Fondacioni i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë ka vendosur të ndajë 2 000 euro, respektivisht nga 1 000 euro për familjet

e dy punonjësve të cilët humbën jetën në këtë aksident tragjik, inxhinieri Haki Arifi dhe xehetari Idriz Gërbeshi. Duke vlerësuar punën e veshme të të gjithë punonjësve në Kosovë, Oda Amerikane fton autoritetet përkatëse që t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme për ngritjen e kushteve të sigurisë për minatorët si dhe të gjithë punonjësit e tjerë në Republikën e Kosovës", është thënë në njoftim e OEAK-ut. Po ashtu, Qeveria në detyrë e Kosovës në mbledhjen e së martës ka marrë vendim për ndarjen nga 30 mijë euro për dy familjet e minatorëve që kanë humbur jetën të martën në minierën e Artanës.




ASK-ja: Çmimet e importit në Kosovë pësuan rënie

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importeve në Kosovë (IÇIMP) për tremujorin e parë (TM1) të vitit 2020. Sipas ASK-së, indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë ka pësuar rënie për -0.6 për qind në TM1 të vitit 2020 krahasuar me TM4 të vitit 2019. Rënie më të mëdha të çmimeve, sipas sektorëve, ishin: produktet minerale (-8.3 për qind); tekstili dhe artikujt e tekstilit (-3.6 për qind); vajrat ushqyese (-3.0 për qind); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-0.5 për qind); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-0.5 për qind); druri dhe artikujt e tij (-0.5 për qind); lëkura dhe artikujt e saj (-0.3 për qind); artikujt ushqimorë të

përgatitur, pijet dhe duhani (-0.3 për qind); artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (-0.2 për qind); dhe instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinale dhe muzikore dhe mekanizmat e orës (-0.1 për qind). "Rënia u neutralizua kryesisht nga ngritja e çmimeve sipas sektorëve te: produktet bimore (15.3 për qind); këpucët (1.8 për qind); mjetet e transportit (0.9 për qind); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (0.6 për qind); shtazët e gjalla, produktet e shtazëve (0.5 për qind); artikujt e ndryshëm të prodhuar (0.2 për qind); dhe produktet e industrive kimike (0.1 për qind)", ka njoftuar ASK-ja.

Më tutje, ASK-ja ka theksuar se



çmimet e importit në Kosovë kanë pësuar rënie në një mesatare prej -0.6 përqindësh ndërmjet TM1 të vitit 2019 dhe TM1 të vitit 2020. "Rënie më të mëdha, sipas sektorëve, kishte te: instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore

dhe muzikore dhe mekanizmat e orës (- 21.8 për qind); tekstili dhe artikujt e tekstilit (-13.4 për qind); produktet minerale (-9.1 për qind); vajrat ushqyese (-3.9 për qind); lëkura dhe artikujt e saj (-2.9 për qind); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-

0.8 për qind); letrat dhe artikujt e saj (-0.6 për qind); druri dhe artikujt e tij (-0.5 për qind); dhe artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (-0.2 për qind). "Rënia u neutralizua kryesisht nga ngritja e çmimeve sipas sektorëve te: produktet bimore (26.6 për qind); shtazët e gjalla dhe produktet e shtazëve (3.3 për qind); këpucët (3.0 për qind); artikujt e ndryshëm të prodhuar (1.6 për qind); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (1.3 për qind); artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (1.1 për qind); mjetet e transportit (1.0 për qind); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (1.0 për qind); dhe produktet e industrive kimike (0.2 për qind)", ka njoftuar ASK-ja.

Mehmeti dhe përfaqësuesit e odave ekonomike diskutuan për rimëkëmbjen e ekonomisë

PRISHTINË, 3 QERSHOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur në takim kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi dhe drejtorin ekzekutiv të Odës Ekonomike Amerikane

(OEAK), Arian Zeka. Ky takim është mbajtur në kuadër të takimeve të rregullta të cilat guvernatori Mehmeti i ka mbajtur me aktorët e ndryshëm, me qëllim të diskutimit të zhvillimeve ekonomike gjatë dhe pas pandemisë. "Guvernatori Mehmeti i njoftoi

përfaqësuesit e odave lidhur me zhvillimet e fundit në sektorin financiar dhe planeve të mëtejme të BQK-së për ta ndihmuar rimëkëmbjen e ekonomisë. BQK-ja mbetet e përkushtuar të kontribuojë në lehtësimin e mëtejme të qasjes në financa përmes rolit të saj si

rregullator dhe mbikëqyrës i sistemit financiar", ka njoftuar BQK-ja. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e odave ekonomike kanë paraqitur pikëpamjet e tyre për ekonominë e vendit si dhe për masat mbështetëse që duhet të ndërmerren për ta tejkaluar këtë gjendje me sa



më pak pasoja për ekonominë dhe për t'i dhënë një shtytje më të madhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Qeveria Kurti ndau edhe 12 milionë euro për pakon emergjente fiskale

Në mbledhjen e fundit të qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti është marrë vendim për ndarjen e 12 milionë eurove për pakon emergjente fiskale. Po në këtë mbledhje është marrë vendim që të mbulohen shpenzimet e Kartonit të Gjellbër për diasporën që vjen në vendin tonë. Kabineti qeveritar në mbledhjen e fundit ka marrë edhe vendime të tjera, mes të tjerash, edhe për shkarkimin e bordit të drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Mitrovica"



marrë edhe disa vendime të tjera, mes të tjerash, edhe për shkarkimin e Bordit të Rajonale të Ujësjetës të Kompanisë "Mitrovica".

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Në orët e fundit të mandatit qeverisës, Qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti, të mërkurën në mbledhjen e 39-të të saj ka ndarë edhe 12 milionë euro për pakon emergjente fiskale. Pakoja fiskale ishte miratuar më 30 mars, me qëllim të zbutjes së ndikimit të pandemisë Covid-19 në ekonominë e vendit. Më 17 maj qeveria në detyrë kishte bërë ndarjen e mbi 10 milionë eurove për masat që do të ndërmerren në kuadër të kësaj pakoje. Shuma e përgjithshme e pakos emergjente kap shifrën rreth 180 milionë euro. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), në një raport të publikuar së voni, ka paralajmëruar se situata pas pandemisë më shqetësuese pritet të jetë në tregjet dhe ekonominë në zhvillim, ku bën

pjesë edhe Kosova, ndërsa Banka Botërore (BB) në raportin e vet të fundit të publikuar më 29 mars ka paraparë një rënie ekonomike në Kovë prej 4.5 përqindësh.

Në këtë mbledhje qeveria në detyrë ka ndarë 60 mijë euro për familjet e dy punëtorëve që humbën jetën të martën derisa ishin duke punuar në minierën e Artanës. Kabineti qeveritar ka

Qeveria merr vendim t'i mbulojë shpenzimet e Kartonit të Gjellbër për diasporën

Qeveria në detyrë e udhëhequr nga Albin Kurti në mbledhjen e fundit ka marrë vendim që t'i mbulojë shpenzimet e Kartonit të Gjellbër për diasporën që vjen në vendin tonë. Me propozimin e ministrit në detyrë të Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi, ky mbulim do të bëhet përgjatë vitit 2020. "Ministria e Financave dhe Transfereve ka dalë me një

draft për Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike, ku një ndër pikat në kemi paraparë edhe marrjen e obligimit nga ana qeveria për lirim dhe koston së Kartonit të Gjellbër me diasporën. Unë nxjerr para juve një propozim-vendim që t'i mbulojë koston për këtë gjatë vitit 2020", ka deklaruar Bislimi. Në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes

Ekonomike, qeveria kishte planifikuar që ta marrë përsipër mbulimin e koston së polisave kufitare për automjetet që hyjnë në vend për vitin 2020. Po ashtu, zëvendësministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, kishte njoftuar se është planifikuar që në 24 muajt në vijim të emetohen letra me vlerë në masën e 30 milionë eurove te diaspora.

Eurostat: Kosova ka çmimet më të ulëta të rrymës në Evropë



EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Konsumatorët shtëpiakë të Kosovës, sipas raportit më të fundit të Agjencisë të Statistikave të Bashkimit Evropian (Eurostat), paguajnë çmimet e energjisë elektrike më të ulëta në Evropë. "Raporti i publikuar së fundmi, që merret me analizimin e pjesës së dytë të vitit 2019, thekson se çmimet energjisë elektrike në Kosovë për amvisëri ishin 6.1 euro për 100

kilovatë/orë. Madje Kosova ka diferencë të madhe me vendin e dytë, ku është renditur Serbia që kishte çmime 7.2 euro apo 18 për qind më shtrenjtë", është thënë në komunikatën e KEDS-it. Sipas kësaj komunikate, vendet e tjera të rajonit kanë çmime shumë më të shtrenjta të energjisë elektrike. "Konsumatorët shtëpiakë në Bosnjë paguajnë 8.71 euro për 100 kilovatë/orë apo 44 për qind më tepër se në Kosovë, ndërsa në Shqipëri 9.1 euro apo 50 për qind më tepër se ne. Ndërkohë,

Mali i Zi është më i shtrenjti në rajon me 10.1 euro. Pra, malazezët paguajnë çmime të energjisë elektrike 65 për qind më të larta se kosovarët", është thënë në këtë komunikatë. KEDS-i ka theksuar se Eurostatin në vazhdimësi përcjell ndryshimet e çmimeve të energjisë elektrike si brenda ashtu edhe jashtë BE-së dhe është përgjegjëse për publikimin e statistikave me cilësi të lartë në mbarë Evropën që mundësojnë krahasime midis vendeve dhe rajoneve.

Mjegulla Kosovë - Shqipëri dhe njerëzit e mirë të luftës



Bedri ISLAMI

Këto ditë, kur në Kosovë mund të ketë zhvillime të papritura dhe, ndoshta, munduese jo vetëm për atë pjesë të kombit, po shfletoja pjesë nga ato që kam shkruar gjatë luftës apo nga shënimet që kam mbajtur. Thuajse të gjithë ata që janë sot pjesë e debatit dhe mund të jenë edhe të përplasjeve, gjenden në ato rreshta dhe shënime. Edhe atëherë, si tani, të ndarë në dy pjesë: disa prej tyre ishin dhe vazhdojnë të jenë miq të mi, pjesë e rëndësishme e lëvizjes klandestine dhe çlirimtare, të tjerë renegatë të luftës dhe dëmtues të saj.

Paqja, thonë, i urtëson njerëzit e luftës dhe i zemëron njerëzit që ishin kundër saj. Në luftë, si pak herë të tjera, ndodh që në jetën e njeriut shfaqen vlerat. Është ai momenti kur pak gjëra mendohen në jetën vetjake dhe ridimensionohet koha. Në paqe, për fat të keq, ndodhi ndryshe.

Në fillimin e vitit 1998 dhe gjatë gjithë kohës që erdhi më pas, askush nuk mund ta mendonte se 22 vjet më pas mes Kosovës dhe Shqipërisë në nivelet e larta qeveritare do të kishte kaq shumë mjegull dhe se meritë e vogla do të ishin mbi interesa të mëdha.

Mendova t'i ribotoj disa pjesë të asaj kohe. Ndoshta mendoj se shokët e dikurshëm me njëri-tjetrin dhe sot në pragje të ndryshme do të rikthehen në kohë dhe t'i rishfaqin vlerat e luftës që disa i humbën në paqe.

Shpeshherë, ndërsa jam ndalur për ta shikuar ciklin "Memoria e luftës", si dëshmi për atë që ka ndodhur në disa nga momentet më të vështira dhe më përcaktuese për fatin e shqiptarëve në Kosovë, por edhe më gjerë se kaq, kam menduar edhe për diçka tjetër, të cilën nuk mund të mos e sillja në mesin e këtij cikli, si një reportazh të porsafilluar, për mijëra e mijëra njerëz ose, thënë më mirë, si shenjë nderimi për atë që kanë bërë njerëzit e zakonshëm, të pazgjedhurit në organet drejtuese të strukturave të ndryshme, por që, megjithatë, kanë bërë pjesë në historinë e një vendi. Dhe, për fat të bardhë, në historinë e vendit të

tyre.

Më tepër se gjithçka, ky shkrim, fillim reportazh, ose mirënjohjeje, besoj se do të sjellë një diçka sado të vogël për ata mijëra e mijëra njerëz që nuk folën e nuk thanë fjalë të mëdha, që nuk rendën pasa emrit për të qenë dikush, që nuk u shushatën kur duhej ngritur krye dhe që ashtu denjësisht e bënë detyrën e tyre.

Në Kosovë, kjo tashmë dihet nga të gjithë, është bërë një luftë.

Në Kosovë, për më shumë se disa dekada shtypjeje, nuk kishte heshitur shpirti dhe zëri kryengritës dhe ky ishte tabani më i denjë për të bërë një luftë. Nëse do të kishte ndodhur ndryshe, pra nëse njerëzit do të ishin mësuar me shtypjen, me kokën e ulur dhe qafën e shtrime, atëherë do të kishte qenë tepër e vështirë, për të mos thënë e pamundur, për të filluar dhe për të bërë të mundur fitimin e një lufte. Nëse Ushtria Çlirimtare e Kosovës u rrit me një shpejtësi marramendëse, që nga marsi i vitit 1998 dhe deri në qershorin e këtij viti 1999, për të mbetur pastaj një forcë solide, e qëndrueshme dhe e aspiruar drejt lirisë me çdo kusht; kjo ndodhi edhe nga fakti se ishte gjetur terreni i duhur për ta bërë këtë.

Është e vërtetë se ata që e ideuan, që punuan me vite dhe që bënë gjithçka që ishte e mundur, ishin në fillim një grup jo i madh idealistësh, e shumta e tyre bënte pjesë në një organizatë ilegale thellësisht patriotike dhe thellësisht të përkushtuar, Lëvizja Popullore e Kosovës e atyre viteve; është e vërtetë se këta njerëz ishin të denjë për të mbartur mbi vete fatin e një populli dhe se e kishin përkushtimin e nevojshëm për të bërë një punë të tillë, aspak të zakonshme; është e vërtetë po ashtu, se ata nuk mund ta bënin këtë vetëm, ashtu fillikat, edhe po të kishin qenë njëmijë vetë, kur fillimisht ishin shumë më pak se kaq.

Ka qenë ndoshta gjëja më e domosdoshme, jetike do të thosha, që nga brezi idealist, i cili kishte marrë përsipër shkëndijimin e idesë së lirisë, të shkohej tek zjarri që do të duhej ndezur tek njerëzit e zakonshëm. Bërja ose jo e kësaj pune, pra shumëfishimi i vetvetes, së këtij brezi idealist, ka qenë guri i madh i provës. Dhe, nëse kjo është bërë denjësisht, ka lidhje edhe me faktin, se njerëzit, megjithëse kishin pritur, nuk kishin fjetur, dhe megjithëse dukeshin të heshitur, kishin pritur rebelimin

e madh. Këtë të vërtetë e kishin kuptuar më së miri ata që edhe kishin qenë më pranë njerëzve të thjeshtë, ata që ishin ngritur për të rrezatuar në jetën e popullit, qoftë edhe me çmimin e madh të flijimit.

Më vjen keq që shembujt e jashtëzakonshëm që mund të sillja nga vitet e luftës brenda në Kosovë nuk janë të shumtë, kjo edhe për faktin se ata vetëm i kam dëgjuar dhe nuk i kam jetuar, ndryshe sa ka ndodhur me ngjarjet që kam përjetuar në mesin e mërgatës shqiptare.

Por, ajo që më ka bërë përshtypje në natën e parë në Prishtinë, në qershorin e vitit 1999, menjëherë pasi lufta kishte heshitur, qëndron në një fakt tepër të natyrshëm.

Një natë më parë në Prizren kishim përfunduar seancat e para të Mbledhjes së Përgjithshme të Lëvizjes Popullore dhe ishte marrë vendimi për shndërrimin e saj në një parti politike të kohës. Ishte ngritur Grupi i Punës për të drejtuar këtë proces dhe me propozimin e Hashim Thaçit, atëherë drejtues i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, unë isha zgjedhur si drejtues i këtij grupi.

Për pak ditë do të duhej të bëhej një punë e jashtëzakonshme dhe ishte e natyrshme që punët të bëheshin me orë të zgjatura, takime të shumta, pasi mendohej se do të ngriheshin struktura më të gjëra sesa ato që kishte pasur deri atëherë Lëvizja Popullore e Kosovës. Duheshin bërë takime të shumta, të njëpasnjëshme, jo vetëm me drejtues të organizatave të tjera politike apo studentore, por edhe me disa nga shokët tanë, të cilët atëherë heshitazi, e më pas haptazi, nuk kishin qenë dakord me shndërrimin e Lëvizjes Popullore të Kosovës në parti politike. Sidoqoftë kjo është një temë tjetër, e cila patjetër një ditë do të duhet të trajtohet ashtu si ka ndodhur, duke sjellë hollësi të nevojshme nga të gjitha takimet që janë bërë aso kohe.

Paraprakisht, ditët e fillimqershorit të vitit 1999

Por, le të kthehemi tek ato ditët të fundqershorit të vitit 1999. Ne kishim zënë vend ose, si të thuash, ishim bujtës të mirëpritur në shtëpinë e Ramadan Avdiut. Kur them "ne" e kam fjalën se ishim disa vetë që flinim e ushqeheshim aty, mes të cilëve Halil Selimi, Ramiz Lladrovci, Sabri Kiqmari,

herë pas here vinin edhe shokë të tjerë si Shaban Shala i Negrovcit, që dukej sikur kishte ardhë nga çetatat e Isë Boletinit, serioz, i mbarë, atdhetar i shquar, mendar, Xhevat Bislimi, Jashar Salihu, Xhavit Hoxha e të tjerë. Pra familja e Danit ishte dyfishuar, por kjo nuk ishte prej ditës së parë. Ato dy shtëpi, fillimisht shtëpia e vjetër dhe më pas shtëpia e re e cila atëherë ende nuk ishte ndërtuar si duhet, për shumë vite kishin qenë shtëpi të ilegalëve të shumtë, të cilët, edhe kur ishte më vështirë se kurrë ishin strehuar aty, kishin gjetur strehën e duhur dhe fjalën e ngrohtë. Në një shtëpi të tillë kjo ka qenë tepër e natyrshme të ndodhte kështu, pasi Ramadan Avdiu kishte qenë për disa kohë njëri ndër drejtuesit kryesorë të Lëvizjes dhe po ashtu e gjithë familja e tij ishte e përfshirë në këtë ilegalitet. Por, ajo që më gëzonte dhe që më bënte përshtypje ishte në faktin, se thuajse të gjithë shokët që kishin ardhur nga ilegaliteti, atyre ditëve nuk kishin zënë vend as në hotele, as në farefisën e miqtë e familjes, por pikërisht në shtëpitë e njerëzve të mirë ku ishin strehuar edhe gjatë kohës që kishin qenë ilegalë në Kosovë.

Në njërin prej mbrëmjeve të para ne ishim në Prishtinë me Bardhyl Mahmutin, përfaqësuesin e njohur politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Perëndim, më pas ministër i jashtëm. Bardhi ishte edhe asaj mbrëmje gjithnjë impulsiv, por kësaj here ai kishte më të drejtë se kurrë. Kishte vetëm dy mbrëmje që ishte në Prishtinë e ëndërruar prej kohe, shumë nga shokët e tij kishin rënë në luftë, por ai tashmë mund të shihte të realizuar ëndërrën e shokëve. Ndërkohë, pasi më thanë se më kishin kërkuar, donim të takoheshim me Ali Ahmetin dhe Fazli Velion, të dy nga drejtuesit më të njohur të Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe në strukturat e larta drejtuese të UÇK-së.

Në rrugën kryesore të Prishtinës ishte një gëzim i përgjithshëm, mijëra vetë kishin dalë nëpër rrugë dhe thërrisnin për Kosovën e lirë, për UÇK-në, dëgjoheshin thirrjet e para për Thaçin, që ishte aso kohe njeriu i shpresës së madhe të tyre, dëgjoheshin këngët, boritë e makinave dhe ne ishim mes tyre. Makina jonë ecte ngadalë dhe prej saj dëgjohej marshi i UÇK-së, kur një vajzë e re futi gjysmën e kokës brenda në makinë dhe thirri: "E pse ju nuk i bini borisë, a ju dhemb dora a,

sonte është fitorja e UÇK-së e ju as borive të makinave nuk po i bini". Ajo deshi të thoshte edhe diçka, e indinjuar, përse boria e makinës sonë nuk dëgjohej edhe aq, por njëra nga shoqet e tërhoqi dhe i tha se ai që ishte në makinë ishte Bardhyl Mahmuti. Ishin emrat e parë të ilegalëve që po bëheshin shpejtësisht të njohur.

Por, ne donim të takoheshim me Aliun dhe Fazliun dhe nuk e dinim se ku. Befas Bardhi tha: "Unë e di se ku janë. Nuk kanë se ku të jenë tjetër veçse te baca Abdyl, tek Abdyl Makolli". E pyeta nëse ishte i sigurt. Nuk kanë ku të jenë tjetër, tha edhe një herë. Ajo ka qenë baza jonë gjatë luftës dhe viteve të ilegalitetit. Njëra ndër bazat më të rëndësishme. Ajo ka qenë bazë edhe për Abazin (Ali Ahmetin) e edhe për Dajën e Madh (Fazli Velion). Ata kanë qenë bazë e ilegalëve edhe në kohërat më të rrezikshme dhe nuk kanë kursyer asgjë për këtë qëllim.

Shkuam, shtëpia ishte në njërin nga kodrat e Prishtinës dhe derën na e hapi një vajzë e re, rreth të 15-tave. Ajo, pa folur asnjë fjalë, iu hodh në krahë Bardhit duke thirrur: "Bardhi". Mendova se mos ishte njëra nga motrat e Bardhytit, por kishte qenë në fakt vajza e Abdyl Makollit. Bardhi, ashtu si edhe Abazi (Ali Ahmeti), Fazliu dhe të tjerë ishin si djemtë e vëllezërit e asaj shtëpie.

Më vonë Bardhi më tregonte, se kur kishte dashur të arratisë jashtë Kosovës, ishte nisur pikërisht nga ajo bazë e Lëvizjes, ishte shoqëruar deri në Slloveni pikërisht nga djali i asaj shtëpie, Shasivar Makolli, i cili më pas kishte shoqëruar kudo Adem Demaçin, por ajo ishte njëkohësisht edhe një shtëpi bazë për shpërndarjen e literaturës në të gjithë Kosovën. Njerëzit e kësaj shtëpie ishin të lidhur me luftën deri në vetëflijim, dhe kjo ndodhi sepse ata i hapën dyert për njerëz që mbartën me vete ideale të mëdha, ideale për të cilat ia a vlen të hapësh edhe portat e zemrës. Më erdhi mirë që shokët e mi kishin aq shumë shtëpi të hapura natyrshëm për to, njëlloj si shtëpitë e prindërve të tyre.

Sidoqoftë, le të kthehemi përsëri aty ku edhe ndjehem "më i sigurt", në ngjarje të tilla të vogla, por me të cilat ka qenë e mbushur gjithë një veprimtari, me njerëzit e mirë të luftës në Perëndimin e largët, por që sollën Kosovën afër tyre me gjithçka që bënë, me idetë që i mbrojtën, me atë përkushtim të

veçantë të heshtur, tepër njerëzor dhe tepër të pabujë. Ka qenë e pamundur të mbështetet Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe qëndresa jetësore e popullit në Kosovë, nëse nuk do të kishin qenë pikërisht këta njerëz të mirë, të lidhur me luftën deri në vlerat e jetës së tyre. Mund të thuhet për shembull, se pikërisht nga familjet e këtyre njerëzve të mirë u nisën nga Perëndimi dhe shkuan drejt radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pra drejt luftës, më shumë se 10 mijë vet, të gjithë të gatshëm për të dhënë edhe më sublimen, jetën e tyre.

Njerëz të politikës, mos i harroni ato!

Mund të thuhet për shembull, se pikërisht nga këta njerëz të zakonshëm e tepër të urtë, u bë i mundur grumbullimi i mjeteve për mbiqëndresën në Kosovë, se ishin pikërisht këta, që duke lënë pas gjërat e zakonshme, bënë shumëçka për të mbështetur luftën në Kosovë. Nuk mund të mendohet lufta në Kosovë pa përkushtimin e atyre që ishin jashtë saj. Dhe unë e di se kjo nuk ka qenë përherë e lehtë. Nuk ka qenë e tillë, edhe pse nganjëherë e jo vetëm nganjëherë, duhej të thyeshin rregullat e ligjet e shtetit ku jetonin, por edhe sepse struktura të tëra udbashe e kosiste në mërgim, të organizuara prej kohe, po bënë gjithçka ishte e mundur për të prishur gjithçka që po ngrihej. "Strukturat paralele", që mjerisht nuk shkonin po ashtu paralelisht në të mirë të qëndresës dhe të së ardhmes së Kosovës, si në legjendat e njohura, donin të prishnin natën, tinëzishit, atë që ishte ndërtuar ditën.

Nuk mund të kuptohet lufta dhe ngjarjet e luftës në Kosovë pa këto njerëz edhe për një fakt tjetër: sepse tashmë, me përmasat e luftës dhe atë që do të vinte, askush, asnjë organizëm politik, nuk mund ta bënte fillikat, vetëm me anëtarët e saj, atë që duhej të bëhej dhe që ishte e përmasave të jashtëzakonshme. Nëse Lëvizja Popullore e Kosovës arriti të bënte shtrirjen e ideve të saj, dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, çka ishin të njëjta, kjo ndodhi, sepse ajo doli nga kornizimet, nuk e perceptoi luftën si pronë vetjake, oborin e saj të ngushtë, por shumë më tepër se kaq. Është e vërtetë po ashtu, se në strukturat drejtuese të luftës kanë qenë njerëz të vendosur, të përkushtuar, përgjithësisht nga radhët drejtuese të organizatave ilegale dhe kjo nuk kishte se si të ndodhte ndryshe, por është e vërtetë po ashtu se gjerësia që mori lufta, solli edhe "kufijtë" e ri të mendimit politik në perceptimin e saj. (Vijon)

Aleancat serbe dhe oportunitizmi evropian



Shkruan:
Prof. Agim ZOGAJ

Bashkëpunimi me Rusinë

Serbia e sotme, në planin e politikës së jashtme, në fakt politikës nacionale, mbështetet, frymëzohet në traditën e saj të largët, prej themelimit të shtetit serb e këndej. Është krejt e natyrshme një strategji e këtyre politikës serbe sepse, ideatorët e saj e kuptojnë se, mbi të gjitha, duhet ndjekur politikën e cila të jep rezultate, pra gjithnjë në funksion të planeve për pushtime territoriale. Shikuar nga aspekti historik, Serbia, nga një strategji e tillë, në të shumtën ka dalë fituese. Pra, ka ndërtuar strategji nacionale e cila ka dhënë fryte, e cila e ka mbrojtur interesin serb, i ka sjellë përfitime popullit serbe, edhe kur, tjerët kanë menduar se Serbia ka humbur. Edhe në rastin e luftërave të fundit në ish-Jugosllavi, Serbia, përveçse ngeli pa Kosovën të sunduar gati një shekull, nxori përfitime në Bosnjë e Hercegovinë. Fitoi territor, e krijoi dhe themeloi Republikën Serbe, themelet e së cilës janë vendosur mbi gjenocidin serb ndaj myslimanëve, grave, fëmijëve. Sikur edhe në rastin e Kosovës, ku ushtria pushtuese serbe, në mesin e mbi 16 000 të viktimizeve, vrau edhe 1 000 fëmijë shqiptarë, Serbia, ushtria serbe, shkaktuan

masakra mbi popullsinë myslimane, bëri gjenocid, para syve të Evropës, e cila u bë sikur nuk kuptonte çfarë po ndodhë dhe diplomacia euro-perëndimore lëvizi vetëm nën presionin e fuqishëm të ShBA-së. Tani e 21 vjet Serbia përmes serbëve kosovarë e mban nën kontroll, veriun e Kosovës, madje me pretendimin që, kur të jetë e mundur, t'ia bashkëngjisë shtetit serb. Serbia e sotme vazhdon hapur ta zgjerojë bashkëpunimin me aleatin historik sllav - ortodoks, Rusinë, të cilit i ka mundësuar që në jug të Serbisë, afër Nishit, ta zgjerojë "qendrën humanitare" me shërbimet e inteligjencës së Rusisë. Qendra ruse e inteligjencës i mundëson Rusisë, mbledhjen e informacioneve, të dhënave për të gjitha shtetet e rajonit, të Ballkanit Perëndimor, pra edhe nga Kosova dhe Shqipëria. T'i bëjmë të ditur lexuesit shqiptar se gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, Rusia nuk kishte mundësi që të krijonte aleanca me Serbinë. Serbia ka bashkëpunim të shtuar me Rusinë, sidomos në fushën e gazit dhe naftës ruse. Edhe më konkretisht pjesa e dytë e gazsjellësit Turk Stream të Gazpromit rus planifikohet të kalojë nëpër Serbi. Një pjesë e konsideruar e kompanisë serbe të naftës tanimë është në pronësi të Gazpromit. Në planin ekonomik, Serbia, edhe pse herë pas here, jo edhe me aq vendosmëri, ia ka tërhequr vërejtjen BE-ja, e ka nënshkruar marrëveshjen e tregtisë së lirë me Bashkimin Ekonomik Euro-Aziatik të drejtuar nga Moska. Në të njëjtën kohë, Serbia, me Vuçiqin në krye, as që e ka përfillur idenë për t'iu

bashkuar sanksioneve kundër Rusisë për shkak të pushtimit ushtarak të Krimesë! Në ndërkohë, ka vazhduar të armatoset nga Rusia, duke blerë armatim të rëndë, përfshirë edhe sistemin kundër avionëve, edhe pse ShBA-ja i kishte tërhequr vërejtjen.

Kina në Serbi

Ndërkohë, një nga partnerët e rinj dhe shumë të besuar të Serbisë është Kina, me të cilën Beogradi zyrtar në vazhdimësi e forcon aleancën, edhe pse ShBA-ja është në marrëdhënie të tensionuara me Kinën dhe me Rusinë. Investimet e Kinës në Serbi tani më kanë kaluar shumë prej 9 miliardëve, ndërkohë që Serbia merr ndihma, favore të vazhdueshme edhe nga BE-ja. Këtë të fundit herë-herë e "frikëson" gjoja se, nëse nuk merr ndihmë nga Brukseli zyrtar, NATO pra, edhe nga ShBA-ja, atëherë në Serbi mund të krijohen realitete të reja, të cilat shtetin serb do ta ofrojnë edhe më fuqishëm me Lindjen, me Rusinë dhe me Kinën. Ishte më tepër se qesharake kur lexoje se Brukseli zyrtar ishte shqetësuar për ndikimin kinez në Serbi, sidomos në kohën e Covid-19. Madje një zyrtar i lartë i BE-së u ankua, kuptohet sa për sy e faqe, përse nëpër Serbi po valon flamuri kinez dhe përse po shkruhen parullat "Faleminderit Kinë", ndërsa nuk ka falënderime për BE-në. Për çfarë është fjala, për pa fuqi, për jo sinqeritet, apo është kjo lojë diplomatike e BE-së?

E rëndësishme, Serbia me plot guxim dhe pa pengesë, para syve të BE-së dhe NATO-s, po i forcon

marrëdhëniet ndërshtetërore me Rusinë dhe me Kinën. Serbia, e përkëdhelura e BE-së, e ka kuptuar se tanimë, edhe nën udhëheqjen e serbomadhit Vuçiq, e ka fituar betejën, duke e imponuar veten si shteti më i fuqishëm në rajon, si shteti pa të cilin, sipas serbëve, nuk ka paqe dhe stabilitet në Ballkanin Perëndimor. Mirë me të gjithë, keq me askënd!

E pra, si është e mundur që në geopolitikën e sotme, të post-modernes, një shtet, një regjim, një popull, si ai serb, i cili shkaktoi dhe zhvilloi katër luftëra në hapësirat e ish-Jugosllavisë, të jetë aq i privilegjuar, t'i shpëtojë gjyqimit për gjenocid dhe, tani, fuqishëm të konsiderohet si shtet i cili prodhon paqe, për më keq, shtet nga i cili, sipas serbëve dhe aleatëve të tyre, varet stabiliteti i rajonit, i Ballkanit Perëndimor? Ndërsa në raport me çështjen e Kosovës, mjerisht dhe paturpësisht Serbia, me përkrahjen dinake të aleatëve të saj, jo vetëm Rusisë dhe Kinës, por edhe shteteve të tjera, anëtare të BE-së dhe të OKB-së, paqen me Kosovën po e imponon, po e kushtëzon me një zgjidhje, marrëveshje, sipas së cilës, të dyja palët do të duhej të dilnin fituese.

Pra, kur kemi parasysh çfarë protesta mbarëpopullore po ndodhin në ShBA, si reagim i arsyeshëm i mbytjes tragjike të një qytetari, atëherë përse diplomacia euro-perëndimore është kaq e nënshtruar ndaj Serbisë? Përse BE-ja hesht ndaj faktit që, edhe 21 vjet pas agresionit ushtarak, policor të Serbisë në Kosovë, mbi 1 600 mbetje mortore të civilëve shqiptarë ndodhen të fshehura nëpër malet, lumenjtë, fushat e Serbisë?!

KRU 'Prishtina': S'ka fryrje të faturave dhe as ngritje të çmimit të ujit

PRISHTINE, 3 QERSHOR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) "Prishtina" ka bërë me dije se me të gjitha kapacitetet e saj gjatë kohës së pandemisë është treguar e kujdesshme në raport me konsumatorin, furnizimin me ujë të pijshëm dhe cilësor. Në këtë kontekst, kjo kompani ka theksuar se gjatë kësaj kohe nuk ka fryrë faturat dhe as nuk ka ngritur çmimin e ujit. "Ujësjellësi i Prishtinës nuk ka fryrë faturat e ujit në asnjë muaj. Ujësjellësi në asnjë mënyrë nuk e ka shfrytëzuar pandeminë për t'i 'plaçkitur' qytetarët (siç kanë potencuar

disa banorë të një hyrje bane-sore në lagjen 'Lakrishtë' në njërin nga gazetatat/portalet). Ata kishin potencuar se shumica e tyre nuk kanë ujëmatës individualë dhe faturimi bëhet me ujëmatësin e përbashkët. Jua kujtojmë se tarifat për shërbimin me ujë e kanalizim, përcaktohen nga Autoriteti Rregullator i Ujit (ARrU), me ç'rast nuk ka ngritje të çmimit. Po ashtu, lexuesit (inkasantët) obligim ligjorë e kanë leximin e ujëmatësit (individual apo të përbashkët), së paku një herë në tre muaj. Inkurajojmë të gjithë konsumatorët e ndërtesave që kanë vetëm një ujë-



matës të përbashkët, të vendosin ujëmatës individual e më pas ta regjistrojnë atë pranë zyrës për konsumatorë të KRU 'Prishtina'. Gjatë periudhës së

pandemisë faturimi është bërë mbi bazën e mesatares së konsumit (shpenzimit) gjatë tre muajve të fundit", ka njoftuar KRU "Prishtina".

Heroi i kombit Naser Veli Krasniqi

Me datën 04 qershor, bëhen 22 vjet nga rënia heroike e heroit të kombit Naser Krasniqi, "Leka". Djaloshi sypatrembur dhe i pakompromis, që luftoj për lirinë e Kosovës me okupatorin serbo-sllav, që në rininë e tij të hershme, e deri në rëniën e tij në altarin e lirisë.


Naser Veli Krasniqi lindi më 24 tetor 1972, në fshatin Ratkoc të Rahovecit. Prindërit Veli Krasniqi dhe Mihrije Xhyliqi Krasniqi, gjithsejtë kishin shtatë fëmijë: katër djem e tri vajza, Naseri ishte fëmija i tretë i tyre. Dëshmori Naser Krasniqi shkollën fillore e kreu në Ratkoc, ndërsa të mesmen në Rahovec dhe Prishtinë. Studimet Universitare, Fakultetin e Kulturës Fizike e la në gjysmë për shkak të kycjes së tij në luftë. Më aktivite shoqërore atdhetare



Naser Krasniqi -Leka

filloi të merret qysh si ri. Naseri ishte në klasën e 6-të kur i motivuar nga familja, rrethi shoqëror dhe ngjarjet politike të kohës, e theu fotografinë e Titos (ish- kryetarit të Jugosllavisë). Vitet 1988/89 shënuan kulmin e diskriminimit politik të shqiptarët e Kosovës, kur serbo-jugosllavët suspenduan Autonominë e Kosovës. Në kontekst të këtyre ngjarjeve, Naser Krasniqi ishte njëri ndër protagonistët, protestuesit që me ditë dhe muaj nuk ndaloj së vepruari në demonstrimin, politik, organizativ dhe fizik.

Në demonstratat popullore që u organizuan në Ratkoc, fshatrat




përreth, në qytetin e Rahovecit, dhe në tërë Kosovën, Naseri ishte pjesa më skenografike e demonstratave, duke qenë në ballë të tyre, i mbuluar gjoks e shpinë me flamurin tonë kombëtar shqiptar e me plisin e bardhë mbi vetull, ku pushtuesve serbë i bie në sy veprimi i tij dhe që nga ajo kohë vazhdimisht kërkohet nga policia. Në vend që të niste studimet në fakultet, ai u detyrua ta linte Kosovën dhe përkohësisht të shkonte në Gjermani. Me t'u vendosur atje, vë kontakte me shumë shokë e miq që vepronin për çështjen kombëtare. Kjo formë e bashkëpunimit i ndihmoi atij që ta ruante vazhdimësinë dhe të kthehej prapë në Kosovë për ta vazhduar përgatitjen për luftë. Pas kthimit të tij në atdhe, në shtator të vitit 1996, veprimtarinë patriotike do ta vazhduante fillimisht në vendlindje, në Ratkoc, përmes organizatës ilegale të quajtur Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK). Naseri në cilësinë e idealistit të organizuar, aktivitetin e tij e filloi



Naser Krasniqi me babain Veli Krasniqi gjate qëndrimit të përkohshëm në Gjermani

menjëherë me shpërndarjen e pamfletesh "Çlirimi", organ propagandistik i LKÇK-së, e pastaj edhe me aktivite të tjera ilegale. Disa ndër të janë; agitimin dhe propagandimin e luftës çlirimtare, vëzhgimi i lëvizjeve të forcave policore dhe veprimeve të kolaboracionistëve, transportimin dhe sistemimin e mërgimtarëve vullnetarë të ardhur nga perëndimi në luftën e Kosovës, bartjen e armatimit dhe municioneve, medikamenteve mjekësore dhe gjërave të tjera në përgjithësi që nevojiteshin për luftë, etj.

Gjatë viteve 1997-98, ekskluzivisht veptoi edhe në Prishtinë. Aktiviteti i tij në kryeqytet, sidomos tek qarqet studentore, do ta identifikonte portretin e tij si djaloshi mistershëm i natës. Ai, në cilësinë e studentit të UP-së të



Fakultetit të Kulturës Fizike, do të banojë në një banesë me qira, në lagjen "Vellusha", prej nga do të frekuentonte, koordinonte dhe do të vepronte me aktivitetet ilegale me shumë student atdhedashës nga të katër anët e Kosovës. Më 1 tetor të vitit 1997, Naseri ishte pjesëmarrës aktiv i protestave që u zhvilluan në Prishtinë, përkatesisht tek vendi i quajtur "Velania". Në këto rrethana, Naseri së bashku me shokët e tjerë të fakultetit, u dalluan me veprimet e tyre të shpejta, në ndihmë të studentëve, duke u ndihmuar në strehimin e tyre nëpër shtëpitë private, etj.

Naseri, pas një veprimtarie të

organizuar, ushtruar dhe duke bërë roje nëpër pozicionet e UÇK-së. Në këto pika, Naseri veptoi për rreth 15 ditë, deri më datën 11 maj 1998. Më datën 12 maj, Naseri do të marrë pjesë aktive në luftë ballë për ballë me forcat serbe. Në këtë betejë, pas 10 orë luftimesh të ashpra, ai do të shquhet me guximin dhe trimërinë e tij duke luftuar nga një pikë në tjetrën, nga një pozicion në tjetrin. Në këto përballje, do të shquhet luftëtari sypatrembur, i cili me guxim nxitoi aty ku kërkohet vetëmohimi dhe trimëria, gjithnjë shembull për bashkëluftëtarët. Naserin shumë e tërhiqte uniforma e luftës së UÇK-së dhe shpesh theksonte se uniforma e krijon imazhin e mirë për ushtrinë tonë dhe realisht ishte ndër të parët në rajonin e Anadrinisë që e siguroi dhe e veshi atë, që në fillim të luftës.

Ai ishte protagonist kryesor i formimit të Njësisë Speciale të UÇK-së që vepronte në Ratkoc. Në këtë njësi bënin pjesë djemtë më të mirë të kësaj ane, të cilët ishin të gatshëm të vepronin në çdo çast, aty ku e kërkonte nevoja. Ai për herë të parë e vendosi

flamurin kombëtar në stacionin e policisë, që tashmë ishte shndërruar në shtab të UÇK-së. Naseri me shokë, me të dëgjuar për luftimet që kishin filluar në Gradish, pa mëdyshje e ndërpreu gjumin dhe ashtu siq e kishte bërë shprehur luftë të flente me uniformë, u ngrit në këmbë dhe ia mësyu Gradishit. Dhe prej këtij momenti, përgjatë 12 orëve luftime qëndroi aktiv nëpër pozicionet e UÇK-së. Naseri edhe në këto luftime u dallua prej të tjerëve, me guxim të lartë dhe zhdërvjelltësi luftarake, nën betimin e dhënë për "Liri a Vdekje". Naserin, deri në aktin e rëniës, do ta shohim kudo nëpër aksione e fushëbeteja luftarake, si në Drenoc, Bratotin, Ratkoc, Zatriq, Vranjak, Dejë, Malësi e Vogël, Gradish, etj. Çdo ditë e Naserit ishte përpjekje për të ecur pa hamendje përpara drejt luftës çlirimtare. Naser Krasniqi i njohur me pseudonimin "Leka", duke qenë në krye të detyrës si çdoherë, në mbrëmjen e 4 qershorit të vitit 1998, saktësisht në orë 21 e 26 minuta të mbrëmjes, kur filloi një ofensivë e madhe artilerie serbe e kombinuar me shumë forma luftime, pikërisht aty edhe ku lindi, në Ratkoc (Drinas), në përballje me forcat serbe, bie heroikisht, duke mbrojtur popullin, dinjitetin kombëtar dhe lirinë e atdheut të vet. Vet Naser thoshte: "Në çdo kohë, të luftosh dhe të vdesësh për lirinë e atdheut, ia vlen dhe është modesti. Naseri, u varros në varrozat e fshatit Ratkoc me 5 qershor 1998. Pasë përfundimit të luftës, në shenjë vlerësimi dhe mirënjohje për veprën e tij atdhetare, iu akorduan shumë mirënjohje dhe dekorata, që nga diploma "student martir" që ia dhuroi Universiteti i Prishtinës, e deri te akordimi me urdhrin Hero i Kosovës, i ndarë nga Presidenca e Republikës së Kosovës.



Lapidari i heroit Naser Krasniqi i ndërtuar në vendin e rëniës

Protesta nga Parisi në Sidnei pas vdekjes së George Floyd

Mijëra protestues në Paris kundërshtuan një urdhër të policisë për ndalimin e tubimeve si rezultat i koronavirusit, ndërsa u mbledhën të martën për të protestuar kundër padrejtësisë racore dhe taktikave të ashpra të policisë, ndërsa në mbarë botën është përhapur zemërimi lidhur me vdekjen e George Floyd në Shtetet e Bashkuara.

Me duartrokitje, brohoritje dhe parulla ku shkruhej "Black Lives Matter" dhe "Policia kudo, Drejtësia Askund", turma kryesisht e moshave të reja dhe shumë raciale, vërshoi drejt gjykatës kryesore të Parisit. Protesta ishte paqësore ndërsa policia vëzhgonte nga afër. Me thirrjet "Nuk mund të marr frymë", mijëra njerëz marshuan paqësisht në qytetin më të madh të

vazhdon të jetë i ndaluar në Francë si pjesë e masave për të frenuar përhapjen e koronavirusit.

Megjithatë, protestuesit dolën në rrugë. Disa thanë se dhuna policore u përkeqësua gjatë izolimit nga koronavirusi, kryesisht për shtresat që jetojnë në lagjet periferike dhe u përkasin popullatave pakicë, duke thelluar një ndjenjë të padrejtësisë. Demonstrata të ngjashme u zhvilluan edhe në qytete të tjera të Francës në nderim të Adama Traore, i cili vdiq pak pas arrestimit në vitin 2016, dhe në solidaritet me amerikanët që demonstruan kundër vdekjes së George Floyd.

Rasti Traore është bërë emblemë e luftës kundër brutalitetit të policisë në Francë. Rrethanat e vdekjes së 24 vjeçarit francez me origjinë nga Mali janë ende nën hetime kur



Australisë. Tubime me mijëra njerëz u zhvilluan edhe në kryeqytetin holandez Hagë, ndërsa qindra izraelitë protestuan në Tel Aviv.

Zemërimi u shpreh në shumë gjuhë në median sociale ndërsa mijëra suedezë u bashkuan përmes një proteste në internet dhe të tjerëve që flisnin nën banderolën #BlackOutTuesday.

Edhe diplomacia mori pjesë në zemërim, ndërsa shefi i politikës së jashtme të Bashkimit Evropian tha se blloku ishte "tronditur dhe tmerruar" nga vdekja e afrikan-amerikanit George Floyd.

Ndërsa protestat u përshkallëzuan në mbarë botën, solidariteti me demonstruesit amerikanë u përziej edhe me shqetësimin në rritje mes komuniteteve lokale.

"Kjo ndodhi në Shtetet e Bashkuara, por gjithashtu ndodh në Francë dhe gjetkë", tha protestuesi parisian Xavier Dintimille. Ndërsa u shpreh se dhuna e policisë duket më e ashpër në Shtetet e Bashkuara ai shtoi se, "të gjithë njerëzit me ngjyrë e përjetojnë këtë në një farë mase."

George Floyd vdiq një javë më parë pasi një polic vuri gjyrimin mbi grykën e tij për disa minuta, madje edhe pasi ndaloi së lëvizuri duke kërkuar që merrte frymë. Vdekja e tij nxiti protesta që u përhapën në të gjithë Amerikën dhe tani në mbarë botën.

Frika e koronavirusit mbetet e lartë ndërsa policia citoi këtë arsye për të ndaluar protestën të martën pranë gjykatës në Paris. Grumbullimi i më shumë se dhjetë individëve



kanë kaluar katër vite nga raportet konfliktuale rreth asaj që ndodhi.

Avokati për dy nga tre policët e përfshirë në arrest, Rodolphe Bosselut, tha se çështjet Floyd dhe Traores "nuk kanë asnjë lidhje të ngushtë me njëri-tjetrin". Avokati tha për agjencinë e lajmeve Associated Press se vdekja e 24 vjeçarit Traore nuk ishte e lidhur me kushtet e arrestimit të tij por faktorë të tjerë, përfshi probleme mjekësore të mëparshme.

Familja e zotit Traore thotë se ai vdiq nga asfiksioni si rezultat i taktikave policore dhe fjalët e tij të fundit ishin, "Nuk mund të marr frymë".

"Nuk mund të marr frymë" ishin po ashtu edhe fjalët e fundit të 26 vjeçarit indigjen David Dungay i cili vdiq në një burg të Sidneit në vitin 2015 ndërsa po vihej në kontroll nga pesë roje.

Ndërsa 3 mijë njerëz marshuan paqësisht në Sidnei, shumë thanë se ishin frymëzuar nga një përzierje e simpatisë për afrikan-amerikanët mes protestave të

dhunshme në Shtetet e Bashkuara, dhe për t'i bërë thirrje Australisë për të ndryshuar trajtimin e popullatës indigjene, kryesisht kur flitet për policinë.

Turma kryesisht australiane në demonstratën e autorizuar po ashtu përfshinte protestues nga Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.

"Jam këtu për njerëzit e mi, dhe për të gjithë vëllezërit dhe motrat tona të rena në mbarë botën", tha 46 vjeçarja indigjene Amanda Hill e cila mori pjesë në protestë me vajzën dhe dy mbesat e saj. "Ajo që po ndodh në Amerikë hedh dritë mbi situatën këtu."

432 australianë indigjenë kanë

arsimimi dhe punësimi sesa popullsia e bardhë australiane.

Edhe pse Presidenti Donald Trump shprehu zemërim duke kërcënuar dërgimin e trupave për të shuar protestat e dhunshme, Kryeministri Justin Trudeau i Kanadasë nuk pranoi të kritikonte atë drejtpërdrejt, ndërsa tha se protestat duhet të detyrojnë vetëdijshmërinë ndaj racizmit kudo.

"Të gjithë po ndjekim të tmerruar atë që po ndodh në Shtetet e Bashkuara. Por është koha që ne kanadezët të pranojmë sfidat tona, që kanadezët me ngjyrë përballen me diskriminim çdo ditë. Kanadaja ka racizëm në sistem."

Më shumë protesta në vende të ndryshme të botës janë planifikuar më vonë gjatë kësaj jave, përfshi një sërë demonstratash para ambasadave amerikane të shtunën.

Gjendja në Shtetet e Bashkuara shtoi shqetësimet e diplomatëve. Vërejtjet e shefit të politikës së jashtme të Bashkimit Evropian Josep Borrell në Bruksel ishin më të fuqishmet nga blloku prej 27 vendesh, ndërsa tha se vdekja e Floyd ishte rezultat i abuzimit të pushtetit.



vdekur në paraburgimet e policisë që nga viti 1991, thuhet në një shkrim të gazetës The Guardian e cila citon një hetim nga Komisioni Mbretëror mbi vdekjet e popullsisë indigjene në burje. Australia gjithatë asnjëherë nuk ka nënshkruar një traktat me popullsinë indigjene të vendit, e cila vuan nivele më të larta se mesatarja të vdekshmërisë foshnjore, jetëgjatësi më të shkurtër dhe nivele më të ulta

Borrel u tha gazetarëve se "sikurse populli në Shtetet e Bashkuara, ne jemi të tronditur dhe të tmerruar nga vdekja e George Floyd". Ai theksoi se evropianët "mbështesin të drejtën për protesta paqësore dhe po ashtu ne dënojmë dhunën dhe racizmin e çdo lloji, dhe bëjmë thirrje për uljen e tensioneve."

Ministri i Jashtëm i Gjermanisë Heiko Maas tha se protestat paqësore në Shtetet e Bashkuara pas vdekjes së George Floyd janë "të kuptueshme dhe më shumë se legjitime". "Shpresoj që protestat paqësore të mos çojnë në dhunë, por më së shumti shpreh shpresën se këto protesta kanë një ndikim në Shtetet e Bashkuara."

Më shumë udhëheqës afrikanë po ngrenë zërin mbi vdekjen e George Floyd


"Nuk mund të jetë e drejtë që në shekullin 21 në Shtetet e Bashkuara, ky bastion i madh i demokracisë, vazhdon të përballet me problemet e racizmit në sistem", tha Presidenti Nana Akufo-Addo i Ganës përmes një deklarate, duke shtuar se popullsia me ngjyrë e botës është tronditur dhe shokuar.

Udhëheqësi i opozitës në Kenia dhe ish kryeministër, Raila Odinga ofroi një lutje për Shtetet e Bashkuara, "që të ketë drejtësi dhe liri për të gjitha qeniet njerëzore që e quajnë Amerikën vendin e tyre."

Ashtu si disa në Afrikë që kanë ngritur zërin, Odinga po ashtu theksoi problemet në vendin e tij, duke thënë se gjykimi i njerëzve në bazë të karakterit në vend të ngjyrës së lëkurës "është një ëndërr që ne në Afrikë i kemi borxh qytetarëve tanë."



Mehmet Kraja mbi romanin 'Udhëzime për kapërcimin e detit'



Dorëshkrimi këtij romani, gjatë kohës që i bëra një redakturë të lehtë tash së fundi, më mbajti në mendje një imazh, i cili, mësa duket, do të jetojë po aq sa kujtesa ime për ngjarjet dhe zhvillimet që e kanë nxitur shkrimin e tij: ora policore në Prishtinë, për shkak të demonstratave të pranverës së vitit 1981, apartamenti im në katin e pestë në lagjen e Prishtinës "Kodra e Diellit", dritarja e kthyer nga rruga dhe përball një udhëkryq, në të cilin vigjilonte një patrullë policie, për të zbatuar ndalimqarkullimin. Pamja zgjati disa muaj dhe u përsërit një vit më vonë, në përvjetorin e parë të demonstratave, kur sërish u shpall ora policore dhe shtettrrethimi. Për shumicën njerëzve që jetonin atë kohë, mund të mos ishte krejt e qartë se kujt i bënin roje dhe me kë rrinin gati të luftonin ato patrulla policie, ngase dukej sikur ato bënin luftë me një armik të padukshëm, me idetë, me pikëpamjet, me bindjet, me idealin njerëzor, me frymën e lirisë. Gjatë atyre orëve të gjata policore dhe të ndalimqarkullimit askund nuk kishte armiq realë, ndërkohë që netët ishin tipike mesjetare, të errëta, misterioze dhe kërcënuese. Atmosfera ishte e zymtë dhe Prishtina jetonte ditë ankthi dhe terrori. Mbi të gjitha, Kosova mbante mbi vete barrën e rëndë të vasalitetit, nga njëra anë, dhe të lirisë së ëndërruar dhe të paarritshme, më anë tjetër. Ky

dualizëm në qenien e saj e bënte Kosovën të përjetonte traumën më të rëndë të të gjitha kohëve: të bënte luftë me veten, me robërinë e vet shpirtërore, me vasalitetin e mendjes dhe të shpirtit, por njëkohësisht edhe me pushtimin real, i cili kërcënonte egërsisht me zhbërjen e substancës dhe të identitetit kombëtar.

Duke e ndjerë këtë atmosferë të rëndë, me t'u kthyer në apartamentin tim në lagjen "Kodra e Diellit", pas një pune gati vetëshkatërruese si redaktor i rubrikës së kulturës në gazetën "Rilindja", ndonëse jo plot tridhjetë vjeç, mbaj mend se gati ma zinte frymën dilema se si mund të nxirrej në një rrëfim letrar një gjendje e këtyllë, pa vënë në veprim mekanizmat e censurës? Në të vërtetë, shkrimtarët e Kosovës tashmë e kishin fituar një lloj përvoje që, në rastin e disidencës nacionale, ta kthenin mekanizmin e censurës në një lloj vetëcensure, kryesisht përmes metaforave në poezi, ose përmes rrëfimeve alegorike në dramë dhe në prozën romanore. Historia në këtë rast nuk do të shërbente për të sjellë në vëmendje kohë të lavdishme, siç ndodhte zakonisht, por kohë të errëta dhe kërcënimit e zhbërjes së qenies kombëtare.

Që kënde, pra, mund ta kenë origjinën disa komponentë themelorë të këtij rrëfimi, të cilët, po të zberthehen alegoritë, marrin

këtë kuptim: Kosova jetonte një kohë të pushtimit dhe të pamundësisë së frikshme; jetonte një inkuizicion modern. Me autonominë e saj të nëpërkëmbur, ajo ngjante me një principatë mesjetare, e cila ishte e detyruar të njihnte pushtetin suprem të mbretit, si dhe trillet ideologjike dhe represionin kishtar. Në kushtet e një luftë të pashpallur dhe në gjendje të shtettrrethimit, ajo përballë me një ushtri dhe aparat represiv, i cili nuk kishte përballë asnjë armik real, pos përbërësve identitarë të një populli, siç ishin gjuha, historia, shkrimi, eposi, gojëdhënat etj. Për të konstruktuar një rrëfim mbi këtë bazë, së pari u desh të ndërtohej konfiguracion imagjinar: një kështjellë diku jo larg detit, me sheshin dhe pallatin e princit në mes, pastaj një ushtri e huaj që e mban të rrethuar atë kështjellë, një kishë me kabanore, konaku me qelat e priftërinjve, përfshirë edhe një numër vetjesh që i bartnin zhvillimet në një hapësirë të tillë: një murg që ruan dhe lexon dorëshkrimet e vjetra, një ipeshkv që vritet, një princ vasal që i zhvillon luftërat me ndërgjegjen e vet, si dhe titullarë të tjerë të kishës; një kont spiun, një kryekomandant ushtrie pushtuese etj.. Aty është edhe atë Brokardi, emrin e të cilit mban vepra me dëshminë e parë të shkrimit shqip: "Udhëzime për

kapërcimin e detit". Dhe në fund, në fjalinë mbyllëse një imazh që paralajmëron atë që do të ndodhë gati njëzet vjet më vonë: "Nëpër një natë me hënë guri i varrit m'u bë kalë dhe unë u ngrita dhe shkova në atë luftë të lënë përgjysmë".

Për të ndërtuar këtë konfiguracion imagjinar të zhvendosur aq larg në kohë dhe për krijuar atmosferën e ngjarjeve autentike, m'u desh një njohje e themeltë e periudhës së mesjetës dhe e bëmave të saj, gjithnjë duke pasur në mendje korrelacionet alegorike të asaj kohe të errët me zhvillimet bashkëkohore. Çuditërisht, pas shumë vitesh pata vërejtur se zhvillimet në rrëfimin tim, përfshirë disa ngjarje dhe personazhe të veçanta, kishte ngjashmëri të madhe me dy romane të shkruar shumë vite më vonë: "Emri i trëndafilut" i Umerto Ekos dhe "Unë jam e kuqja" e Orhan Pamukut. U ndjeva mirë, sepse kisha shkruar diçka që shpjegohet me poligjenezën në art dhe në letërsi: shkrimtarë të ndryshëm, duke përshkruar rrethana identike krijojnë vepra dhe krijime artistike që kanë ngjashmëri me njëra-tjetrën, edhe pa asnjë komunikim të mesvetshëm.

Duke marrë parasysh rrethanat politike dhe atmosferën e rënduar pas vitit 1981, pastaj përmbajtjen e romanit dhe vigjilencën e shtuar të

institucioneve të censurës së fshehtë, dorëshkrimi iu krijua një vonesë për botim, me shpjegimin se titulli fillestar "Dëshmia e vitit 1332" nuk ishte "i përshtatshëm". Ndërkohë, tri vjet pas botimit në Prishtinë, më 1987, romani u ribotua në Tiranë, pa asnjë ndryshim, duke u bërë një nga veprat e rralla të letërsisë së Kosovës që i jepej lexuesit të Shqipërisë pa censurë.

Po në ato vite, me personazhin e Princit vasal dhe me zhvillimet tragjike rreth tij, shkrova dramën "Princi i hijeve" e cila fitoi në konkursin e Teatrit Popullor të Kosovës dhe më pas u vendos në skenën e këtij teatri dhe të Teatrit Popullor të Gjilanit. Shfaqja e Gjilanit mori pjesë në shumë festivale të ish-Jugosllavisë dhe fitoi disa çmime, por edhe vërejte "ideore", sepse glorifikonte të kaluarën shqiptare dhe krijonte një aluzion të papërshtatshëm me zhvillimet dhe rrethanat bashkëkohore.

Pas 35 vjetësh unë vendosa ta risjell këtë roman në vëmendje të ndonjë lexuesi të mundshëm, ndoshta jo për të rikthyer në kujtesë një kohë që nuk na duhet më, por më shumë për të dëshmuar një përvojë shkrimi pak më ndryshe dhe për të mbajtur disi më të plotë tablonë e gjithë mozaikut të letërsisë sonë në një periudhë më të gjatë kohore, e cila tashmë qëndron në kufijtë e historisë. /exlibris

Historia e shëmtisë

Nga: Umberto Eco (citate nga libri "Historia e shëmtisë" ku autori sjell në vëmendje dokumentet se si në epoka dhe kontekste të ndryshme nga i joni, njerëzit kishin të tjera opinione mbi ato që ne marrim si kryevepra)

– Kompozimet e Johann Sebastian Bach-ut janë krejtësisht pa bukuri, harmoni dhe mbi të gjitha qartësi (Johann Adolph Scheibe, Der Critische Musikus, 1737)

– Një orgji zhurmash dhe vulgariteti (Louis Spohr mbi e ekzekutimin e parë të melodisë së pestë të Bethoveen-it)

– Nëse (Chopin) do i kishte dërguar për kontroll muzikat e tij një eksperti, ky i fundit me siguri do i griste... Sidoqoftë, unë vetë kam shumë dëshirë të marr dhe ti gris (Ludwig Rellstab, Iris im Gebiete der Tonkunst, 1833)

– "Rigoletto" – ja është e mangët nga ana melodike. Kjo vepër nuk asnjë mundësi që të futet në repertor (Gazette Musicale de Paris, 1853)

– E kam studiuar për shumë kohë muzikën e atij dinaku finok, dhe... është një bastard pa më të voglën cilësi (Tchaikovsky mbi Brahms-in, shkruar në ditarin e tij)

– Mbas njëqind vitesh "Lulet e së keqes" do të kujtohen thjesht si një kuriozitet (Emile Zola, me rastin e vdekjes së Baudelaire-it)

– Mund të ketë pasur dhuntitë e një piktori të madh, por kurrë nuk e pati vullnetin për t'u bërë i tillë (Emile Zola mbi Cezanne-n)

– Kjo është vepra e një të çmenduri (Ambroise Vollard më 1907 për pikturën "Zonjat nga Avinjoni" të Picasso-s)

– Ndoshta jam pak i ngathët nga mendja, por nuk arrij të kuptoj se si një njeri mund të shkruaj tridhjetë faqe për të përshkruar si



sillet e pështillet në shtrat para se ta marrë gjumi (raport leximi mbi "Recherche" të Proust-it)

– Zotëri, ju e keni varrosur romanin tuaj në një grumbull detajesh që i keni përshkruar mirë, por që krejtësisht të kota (Letra e botuesit të Flaubert-it, për veprën "Zonja Bovari")

– Në romanet tuaja nuk ka asgjë që të shfaqë dhuntitë të veçanta përshkruese, as personazhet, as ngjarjet. Balzaku kurrë nuk do zë vend të rëndësishëm në letërsinë franceze (Eugene Poitou, Revenue de deux mondes 1856)

– Te "Lartësitë e stuhishme" difektet e Jane Eyre shumëzohen për një mijë. Nëse e mendojmë me kujdes, i vetmi ngushëllim që ngel është mendimi që ky roman nuk do

fitojë kurrë popullaritet (James Lorimer, North British Review, mbi Emily Bronte-n, 1849)

– Inkoherenca dhe mungesa e formës të poeziçkave të saj – nuk di se çfarë emëroj ndryshe – janë të frikshme (Thomas Bayley Aldrich, The Atlantic Monthly, për Emily Dickinson, 1882).

– "Mobi Dik" është një libër i trishtë, banal, i patrajtë, madje qesharak... Ai, kapiteni i çmendur, pastaj, është i mërzhitshëm për vdekje (The Quarterly Review, 1851)

– Walt Whitman ka të njëjtin raport me artin sa çka një derr me matematikën (The London Critic, 1855).

– Pak interesant për lexuesin e zakonshëm dhe pamjaftueshmërisht i thellë për

lexuesin specialist (Raport leximi për Francis Scott Fitzgerald-in, "Kjo anë e Parajsës", 1920)

– O Zot, o Zot, nuk mund ta publikojmë. Do të na burgosnin të gjithëve (Raport leximi mbi veprën "Strehimorja" të William Faulkner-it më 1931).

– Dihet se është e pamundur të shesësh histori kafshësh në Amerikë (Raport leximi mbi "Fermën e kafshëve" të George Orwell-it)

– Kjo vajzë nuk duket se ka një perceptim apo ndjenjë se si mundet ky libër të kalojë mbi nivelin e një kurioziteti të thjeshtë. (Raport leximi mbi "Ditarin e Anna Frank-ut", 1952)

– Do të duhej t'ia dërgonim një psikoanalisti, dhe ka gjasa të ketë ndodhur, dhe është shndërruar

në një roman që përmban disa kalime të një leximi të bukur, por dhe i neveritshëm... Rekomandoj që të varrosët për një mijë vjet (Raport leximi mbi "Lolitën" e Vladimir Nabokov-it, 1955)

– "Budenbroovi" nuk janë gjë tjetër vetëm se dy vëllime në të cilat autori na tregon histori të papërfillshme, mbi njerëz të papërfillshëm, me një stil të papërfillshëm (Eduard Engel mbi veprën e Thomas Mann-it, 1901)

– Sapo përfundova së lexuarit "Uliksin" dhe e gjykoj si dështim... është pallavresk dhe i pakëndshëm. Trashanik, por vetëm në kuptimin objektiv, por dhe nga pikëpamja letrare (Nga Ditari i Virginia Woolf-it).

– Ai djalë nuk ka pikën e talentit (Manet-i i shkruan Monet-it për Renoir-in)

– Nga asnjë film mbi luftën civile s'është nxjerrë asnjë qindarkë (Irving Thalberg i Metro-s, për filmin "Fërfëllloi me erën")

– "Fërfëllloi me erën" do jetë fiaskoja më e paharrueshme e historisë së Hollivudit. Jam shumë i lumtur, sepse do turpërohet Clark Gable dhe jo Gary Cooper (i parafundit e kishte refuzuar rolin e Reth Buttlerit).

– Po çfarë të bëj unë me një njeri me veshë të tillë? (Jack Warner pas një prove të Clark Gable-it, më 1930)

– Nuk njeh recitimin, nuk di të këndojë dhe është qeros. Vetëm pak vallëzim (drejtues i Metro-s, pas një prove të Fred Astaire-it, më 1928) / Përzgjedhi dhe përktheu: Gimi Simoni/ Telegrafi

Një film për jetën e Amy Winehouseit mund të lansohet vitin e ardhshëm

Babai i këngëtares së ndjerë Amy Winehouse, Mitch, e ka bërë të ditur lajmin se një film për jetën e vajzës së tij mund të lansohet vitin e ardhshëm.

69-vjeçari, Mitch Winehouse, ka sugjeruar se projekti në fjalë do ta sjellë një portretizim më të sinqertë të këngëtares, e cila vdiq në vitin 2011, krahasuar me dokumentarin e Asif Kapadias të lansuar në vitin 2015, "Amy", për të cilin thotë se e kishte portretizuar raportin e tij me të bijën, në mënyrë jo të saktë.

Duke folu për emisionin e Paul Dananit, "The Morning After", Winehouse tha: "Jemi duke e përgatitur një film të këndshëm, po ashtu një mjuzikëll i Broadwayt do të vijë së shpejti, dhe kështu do të vëmë drejtësi duke e portretizuar bijën time Amy, ashtu siç ishte."

Mitch po ashtu tregoi se skenari i filmit i cili do të jetë biografik,

është në realizim e sipër.

Ai tha se do të jetë i përfshirë në çdo aspekt të realizimit të këtij projekti, përfshirë edhe përzgjedhjen e aktore e cila do ta portretizojë vajzën e tij të ndjerë. "Përzgjedhja e aktorëve do të bëhet me ndihmën time dhe propozimet e producentëve të filmit. Ne do të fokusohemi te ndonjë aktore jo të famshme, teorikisht do të ishte mirë të jetë ndonjë grua çifute nga veriu ose jugu i Londrës, e cila duket dhe tingëllon sikur Amy," ka shtuar tutje Winehouse.

Dokumentari i regjisorit Asif Kapadia, "Amy", pas lansimit kishte arritur ta fitojë një shpërblim "Oscar" dhe dy nominime për çmim "BAFTA", por Mitch Winehouse vazhdimisht e kishte quajtur këtë projekt një "turp", pasi besonte se e portretizon atë si person lakmitarë.



E jashtëzakonshme

I ka vetëm 13 vjet dhe ka katër diploma universitare

Kohët e fundit po dëgjojmë shpesh se si fëmijët po shtynjë kufijtë. Është e rëndësishme që menjëherë të zbulohet inteligjenca dhe talenti i tyre, të paktën kështu thonë prindërit e të diplomuarit më të rinj në historinë e fakulteteve. Jack Rico jeton në ShBA, si 13-vjeçar është "pronar" i katër diplomave



universitare të fushave të ndryshme, të cilat i "fitoi" në një periudhë kohore prej dy vjetëve. Ai diplomoi në historinë e artit, sjelljet sociale dhe vetë-zhvillim, shkencat sociale dhe të sociologjisë.

FOTO E DITES



Një person shihet duke bërë ushtrime në plazhin Boscombe në Bournemouth, në jug të Anglisë, pas lehtësimit të masave ndaj Covid-19. /AFP/

E rrallë

Një artiste ripunon fotografitë e vjetra, duke improvizuar me qëndisje për t'u dhënë "jetë" imazheve

Artistja jordaneze Dana Barqawi po e kalon kohën e saj duke i ripunuar fotografitë e vjetra të palestinezëve të cilat u shkrepën midis vitit 1890 dhe 1940. Sipas mediave të huaja, ajo po punon



nga studioja e vogël në Aman, ndërsa përdor teknika të ndryshme për t'i "ringjallur" veprat e së kaluarës, duke improvizuar me disa qëndisje për t'u dhënë "jetë" imazheve.

BARSOLETA E DITËS



Një e sëmurë shkon në spital. Gjithë pjesa poshtë syrit i ishte nxirë. Mjeku e pyet:
 - Ç'është kjo hematomë kaq e madhe? Kush ju ka rrahur, zonjë?
 - S'është hematomë.
 - Çfarë është, atëherë?
 - Është shenjë dashurie. E kam kujtim nga im shoq. Ma ka lënë dy minuta përpara se ta mbyjsja.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Nëse e nisni mëngjesin me një ego të shëndetshme, do të gëzoni një ditë plot me veprime dhe gjëra interesante, argëtuese për të bërë. Kjo nuk është një nga ato ditë ku ju do të donit të mos bini në sy.</p>	 <p>DEMI Ka qenë një fluks energjie rreth jush për një kohë të gjatë - si pozitive dhe negative. Ju nuk jeni ende në ndonjë pozitë për të zgjidhur problemet dhe për t'u çliuar nga gjërat e këqija, por së shpejti do të ketë dritë në fund të tunelit.</p>	 <p>BINJAKËT Një nga të njohurit e rinj po bën çdo përpjekje për të qenë pjesë më e rëndësishme e jetës tuaj. Por marrëdhëniet tuaja gjithmonë duhet të bazohen në zgjedhjen dhe respektin reciprok, dhe kjo nuk ndryshon.</p>	 <p>GAFORRJA Reagimi juaj i shpejtë do t'ju vijë në shpëtim kur dikush që ka tendencën t'i thotë gjërat pa i menduar mirë. Ju do të zbutni situatën deri në pikë sa pala tjetër do të ndjejë admirim ndaj jush.</p>	 <p>LUANI Ajo që ju mendoni për gjërat është e rëndësishme për njerëzit me të cilët shoqërohemi nesër, por ju duhet të jeni në rregull me faktin se ajo që thoni sonte mund të jetë shumë ndryshe nga ajo që thoni në mëngjes.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Mëdyshjet që keni lidhur me një person të caktuar sot do t'i shprehni me zë të lartë. Do të shikoni që edhe të tjerët mendojnë si ju.</p>
 <p>PESHORJA Dita jote do të ngarkohet me ekstreme, një minutë ju do të ngazëlleshni për ngjarjet e ditës dhe në minutën e ardhshme do të jeni në gjendje të fokusoheni vetëm në gjërat negative ose në gjëra që mund të shkojnë keq.</p>	 <p>AKREPI Një energji e fortë po pulson nesër, dhe ju keni potencial të jeni një forcë jashtëzakonisht pozitive, prandaj përpiguni të përfshihen me sa më shumë akte mirësie që të jetë e mundur.</p>	 <p>SHIGJETARI Do të ndiheni i fortë nesër sepse rrethoheni nga një lloj energjie që i bën njerëzit të mos ju dalin përpara! Kjo fuqi do ju mundësojë që të realizoni shumë gjëra të rëndësishme që më parë i kishit menduar të paretizueshme.</p>	 <p>BRICJAPI Përpiguni të mendoni më shumë për gjërat që kanë të bëjnë me pushimet dhe argëtimin. Mos u angazhoni kaq fort në punë sepse në fund lodhja do t'ju zhgënjë duke bërë që të hiqni dorë.</p>	 <p>UJORI Jeni duke kaluar momente relaksi kjo si pasojë e energjisë pozitive që ju rrethon. Shfrytëzoni këtë moment të mirë për të realizuar diçka që e keni pasur në mendje prej shumë kohësh.</p>	 <p>PESHQIT Përpiguni të krijoni një shprehje fizike të ideve që dëshironi të përcillni. Ju duhet ta ushtroni kreativitetin tuaj sa më shumë që të jetë e mundur nesër dhe të përpiguni të integroni aktivitetin fizik.</p>

Demi Lovato me porosi për Donald Trumpin: Do të paguash për heshtjen tënde



Këngëtarja e njohur Demi Lovato është përfshirë në debatin për personat me ngjyrë. Lovati përmes një postimi në rrjetet sociale i ka reaguar ashpër presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump. Ajo ka shkruar një reagim bashkë me Matthew Scott Montgomery dhe Sirah, pas deklaratave të Trumpit rreth ndalimit të protestave. "Donald

Trump, bëhu lideri që ne kemi nevojë të jesh. Unë, në fakt, po të lutem, sepse jemi të detyruar që të kemi ty president deri në nëntor, pastaj do të detyrohesh të paguash për heshtjen tënde, për mungesë të udhëheqjes dhe veprimeve", ka shkruar ajo. Me moton "Black Lives Matter" tash e sa ditë po protestohet në Amerikë pas vrasjes së afro-amerikanit George Floyd.

Për dallim nga koleget, Kida preferoi tjetër ndryshim në dukje

Kida është një prej emrave më të dashur të skenës muzikore shqiptare e cila njihet për hite të shumta. Këngëtarja njihet për stilin e veçantë në secilën paraqitje të saj, ndërsa nuk janë të rralla ndryshimet që bën në dukje. Së fundi, artistja ka ngjyrosur një pjesë të flokëve me ngjyrë vjollcë, më ndryshe nga koleget e saj, te të cilat nuk kemi parë stil të tillë të flokëve. Kujtojmë se Kida ditët e fundit ka sjellë vazhdimisht imazhe nga seti i ri fotografik, duke lënë të kuptohet se është duke finalizuar këngën e re. Projekti i fundit muzikor i saj është



"Moti", këngë për të cilën pranoi komente pozitive nga fansat.



Modeluesja e njohur dhe partneri i saj marrin pjesë në protesta në Los Anxhelos

Java e fundit ka qenë e mbushur me protesta në Amerikë pas vrasjes së afro-amerikanit George Floyd. Protestuesve u janë bashkuar edhe shumë emra të njohur të cilët po protestojnë kundër brutalitetit të policisë. Protestave me moton "Black Lives

Matter" së fundi iu bashkua edhe modeluesja Emily Ratajkowski dhe partneri i saj. Dyshja janë fotografuar nga paparacët duke mbajtur pankarta në duar, ndërsa nuk mungonin masat mbrojtëse. Ajo publikoi në "Instagram" edhe pamje nga protesta paqësore në të cilën mori pjesë me partnerin.

Cardi B qëndroi zgjuar tërë natën duke bërë një manikyr të stilit neon me ngjyrë të gjelbër

Si shumë prej nesh që kanë qëndruar në shtëpi gjatë pandemisë, Cardi B tani, pas lirim të masave, është drejtuar të bëjë disa nga trajtimet e saj të bukurisë. Cardi B ndau një video në "Instagram"-in e saj në të cilën tregonte thonjtë e saj: një formë e super gjatë, në një hije të gjelbër verore, neoni. Cardi postoi foton përpara se ajo të largohej nga qendra estetike dhe krijimi duket se i ka marrë gjithë natën. "Unë sapo bëra thonjtë e kjo me mori kohë tërë natën", ka shkruar ajo.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Finalisti i Kupës vendoset në Drenas

Pa fitues dhe pa gola të shënuara ka përfunduar përballja në mes të liderit të Superligës, Ballkanit dhe kampionit në fuqi, Feronikelit. Finalisti i kësaj përballjeje vendoset në Drenas pas dy javësh, kurse Prishtina pritet të jetë finalistja e parë pas fitores në ndeshjen e parë ndaj Drenicës (3-0)



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Finalisti i dytë nga ndeshja gjysmëfinale e DigitAlb Kupës së Kosovës në futboll në mes të Ballkanit dhe Feronikelit do të vendoset në ndeshjen kthyesë që zhvillohet në Drenas pasi përballja e parë mes këtyre dy skuadrave që u zhvillua të mërkurën në Suharekë përfundoi 0-0.

Trajneri i Ballkanit, Ismet Munishi, pas ndeshje ka thënë se skuadra e tij ka qenë në disa raste me fat ndaj Feronikelit, por shpreson se në ndeshjen kthyesë kundërshtari do të luajë lojë më të hapur. "E kemi ditur se ata janë kampionë në fuqi dhe nuk është lehtë ndaj tyre. Madje ne patëm fat pasi Feronikeli pati 2-3 raste të na dënonte, kurse ne kishim posedimin. Mendoj se ky rezultat është real para duelit të kthimit. Shpresoj që Tovërlani mos të mbrohet njësoi si këtu edhe në

Drenas, pasi do ta bëjmë ministër të Mbrojtjes (qesh)", ka thënë Munishi.

Ishte sulmuesi i "Niklit", Harmon, i cili rrezikoi i pari në ndeshje, por gjuajtja e tij u bllokua nga mbrojtësi Arbër Prekazi, i cili në janar nga Feronikeli u transferua te Ballkani. Në minutën e 11-të Mëndurim Hoti provoi, por gjuajtja e tij përfundoi jashtë portës së portierit vendës. Në minutën e 34-t Krasniqi harkoi për Dakun që nuk arriti të shfrytëzojë këtë rast për ta sjellë klubin në epërsi. Në fund të pjesës së parë trajneri Ismet Munishi u ndëshkua me karton të verdhë, pas reagimeve ndaj gjyqtarit të ndeshjes. Në fillim të pjesës së dytë Hoti provoi edhe një herë por, pa sukses. Në minutën e 68 Arbër Hoxha harkoi në zonën e kundërshtarit, por portieri Troshupa reagoi duke e devijuar topin. Pesë minuta më vonë Troshupa e ndali edhe gjuajtjen e sulmuesit Daku. Në minutat shtesë

Daku pati edhe një rast të mirë shënimi, por gjuajtja e tij përfundoi lart portës. "Qëllimi ka qenë mos t'i jepet hapësirë treshes së Ballkanit, ndërsa me pak fat kemi mundur të shënonim sepse kemi pasur tri raste të qindpërqindta, por unë i përgëzoj futbollistët e mi për ndeshjen e bërë. Nuk është rezultat i keq, por takimi mbetet i hapur për duelin kthyes. Nuk duhet lëshuar shumë pasi Ballkani luan mirë në udhëtim", ka thënë Tovërlani, i cili ka bërë me dije se në klubin e "Niklit" nuk ka më krizë financiare, pasi të martën janë kryer obligimet ndaj futbollistëve.

Finalisti i kësaj përballjeje do të vendoset në ndeshjen kthyesë që zhvillohet pas dy javësh në stadiumin "Rexhep Rexhepi", kurse nga ndeshja tjetër finales i është afruar shumë skuadra e Prishtinës, pasi të martën në stadiumin "Fadil Vokrri" e mposhti skuadrën e Drenicës me rezultat 3-0.

SHKURT

Dumoshi sërish ministre e sportit

Kryeministri i ri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka prezantuar kabinetin qeveritar. Qeveria e re arriti ta merrte mandatin falë 61 votave. Sporti edhe në qeverisjen e drejtuar nga Avdullah Hoti do të vazhdojë t'i besohet Vlora Dumoshit. Dumoshi ishte ministre e këtij dikasteri edhe në qeverinë para-prake, e drejtuar nga Albin Kurti.

Kryetari i FFK-së urdhërohet ta mbajë dënimin me burg

Kryetari të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi nga Gjykata Themelore e Prishtinës, i është dërguar urdhri për paraqitjen në institucionin për mbajtje të dënimit me burg. Ademi duhet të paraqitet në Shërbimin Korrektues të Kosovës me qendër në Prishtinë, deri më 18 qershor në orën 12:00. Sipas urdhëresës, nëse Ademi nuk paraqitet deri në datën e caktuar atëherë Gjykata Themelore do të lëshojë urdhëresë për ndalim, arrestim dhe dërgim me forcë në Shërbimin Korrektues. Siç dihet, Ademi është dënuar me 9 muaj burg efektiv për detyrim në tentativë. Kundër këtij vendimi Agim Ademi është ankuar edhe në Gjykatën Supreme.

KOK-u shënon Ditën Botërore të Sportit dhe Ambientit

Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) do ta shënojë 5 qershorin - Ditën Botërore të Sportit dhe Ambientit, aktivitet ky tradicional i KOK-ut. Me këtë rast, KOK-u do ta mbjellë Pemën Olimpikë 2020, e cila këtë herë do të mbillet në kopshtin përballë Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport. Krahas kësaj, pjesëmarrëse në këtë ditë do të jenë edhe komunat e Kosovës, të cilat do të mbjellin nga një pemë olimpikë në kompleksin e Universitetit të Prishtinës. Një vit më parë pemë kishin mbjellë klubet sportive.

Drita rinovon kontratën edhe me Cuculin

Ardian Cuculi ka vazhduar kontratën me Dritën edhe për dy vjet të tjera. Lajmi është bërë me dije nga faqja zyrtare e Dritës. "Është arritur marrëveshja për vazhdimin e bashkëpunimit me qendërmbrojtësin tonë Ardian Cuculi edhe për dy vjetët e ardhshëm. Cuculi është një prej lojtarëve kyç të skuadrës andaj drejtuesit e klubit i kanë besuar të jetë me ne deri në vitin 2022. Drejtori sportiv, Valon Zymeri, është shprehur tejet i kënaqur me arritjen e marrëveshjes me Cuculin, të cilin e konsideron tejet të rëndësishëm në projektin e madh që ka klubi. Vazhdojmë të punojmë pa ndërprerë drejt synimeve tona", ka njoftuar skuadra e Dritës. Skuadra nga Gjilani ka rinovuar kontratën edhe me trajnerin Ardian Nuhui dhe kapitenin Ardian Limani.

Istogu: Ndjenjë e jashtëzakonshme të luash për Kosovën

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Shumë basketbollistë nga Kosova luajnë me sukses në arenën ndërkombëtare. Një ndër ta është edhe Bleron Istogu, që aktivizohet për skuadrën slovene Grosuplje. Pandemia Covid-19 ka prekur sportin në

mbarë botën. Edhe Bleroni ka treguar si ka ndikuar tek ai dhe kishte një mesazh. "Përshëndetje. Unë jam Bleron Istogu dhe luaj për KK Grosuplje në Slloveni. Puna po më shkon shumë mirë. Me klubin kam pasur paraqitje shumë

të mira në këtë sezon, por për shkak të pandemisë Covid-19 kemi ndërprerë ushtrimet. Por, formën e trupit po përqipem ta mbaj me ushtrime në shtëpi. Të luash për Kosovën është një ndjenjë e papërshkruar sepse përfaqëson shtetin dhe jep

maksimumin. Mesazhi im për basketbollistët që të mbajnë formën e trupit me vrapime dhe aktivitete fizike derisa të përfundojë kjo pandemi", ka thënë Istogu, me anë të një videomesazhi për faqen zyrtare të FBK-së.



Shala: Do t'i sjell Kosovës medalje olimprike

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka nënshkruar kontratën me mundësin Egzon Shala i cili do ta përfitojë Bursën Olimprike "Tokio 2020". Kontrata u nënshkrua nga presidenti i KOK-ut, Besim Hasani, mundësi Egzon Shala, kryetar i Federatës së Mundjes së Kosovës, Naim Muja dhe trajneri Sylejman Shala. Me fitimin e normës olimprike "Tokio 2020" nga Shala, KOK-u kishte kërkuar nga Solidariteti Olimpik (SO) i Komitetit



Olimpik Ndërkombëtar (KON-it), që garuesit t'i mundësohet bursa olimprike në vend të karateistit Alvin Karaqi, të cilit i ishte ndërprerë pasi vendosi ta përfaqësojë Shqipërinë.

Me kontratën e nënshkruar, prej 1 maj 2020, Shala do të përfitojë nga 350 dollarë nga SO i KON-it. Krahas kësaj, presidenti Hasani bëri me dije se Egzoni do të përfshihet në grupin e parë të sportistëve elitare, të cilët mbështetjen nga KOK-u me dërgimin në përgatitje jashtë vendit për periudhën 80 ditë gjatë një viti kalendarik. "Lajmi se Egzon Shala ka fituar normën olimprike ishte një lajm që ka gëzuar tërë komunitetin e sportit, veçanërisht mundjen, trajnerin dhe vetë Egzonin. Sot është rasti ta përgëzojmë Egzonin për një sukses të jashtëzakonshëm, trajnerin dhe federatën për një punë të bërë mirë sepse asnjë rezultat nuk vjen rastësisht. Janë

diku 50 për qind e shteteve që nuk e arrijnë asnjë normën olimprike, ndërsa Kosova tashmë ka normën olimprike me mundjen dhe xhudon që ka pesë të tilla", ka thënë presidenti Hasani, duke shpresuar se edhe ndonjë sportist i sporteve të tjera do të fitojë normën olimprike, pse jo edhe ndonjë tjetër nga vetë mundja.

Shala ka fituar normën në kategorinë -125 kilogramë, pasi doli i pesti në botërorin e mbajtur në Astana të Kazakistanit vitin e kaluar. 29-vjeçari, duke falënderuar KOK-un dhe IOC-un për mbështetjen, ndihet i sigurt se në Tokio 2020 do të ngjitet në podium. "Dua t'i siguroj të gjithë sportdashësit. Besoj se ka ardhur koha që edhe për meshkuj të fitojmë medalje. Gjatë këtij një viti sa ka mbetur, shpresoj të përgatitem sa më mirë dhe jam më se i sigurt se do të fitojë medalje olimprike", ka thënë garuesi nga Suhareka.

Kryetari i FMK-së, Naim Muja, falënderoi KOK-un për mbështetjen me bursë olimprike dhe përgatitje, derisa theksoi se vullneti i madh i sportistëve, trajnerëve dhe udhëheqësve ka bërë që mundja të përfaqësohet me normë olimprike në Tokio 2020, derisa pret që edhe Edon Shala dhe mundës të tjerë ta fitojnë normën. Trajneri i Egzonit, njëherësh prindi Sylejman Shala, derisa vlerësoi mbështetjen e KOK-ut, me theks të veçantë dërgimin në kampe përgatitore, theksoi se mundja e ka arritur nivelin që e ka pasur më herët. "Do të bëjmë të pamundurën që edhe mundja të ketë medalje në Tokio 2020", ka thënë ai.

Bursa Olimprike nga SO i KON-it marrin 18 sportistë elitare të Kosovës.

Lojërat Olimprike Tokio 2020, të cilat u shtyn në mars të këtij viti, mbahen prej 23 korrik 2021-8 gusht 2021.

Sezoni në NBA përfundon në tetor

FLORIDA, 3 QERSHOR - Kthimi në fushën e lojës për ta vazhduar, me format më ndryshe, sezonin 2019/20 të NBA në fund të korrikut, do të bënte që ndeshja e shtatë e finaleve të NBA-së të zhvillohet në mes të tetorit. Sezoni aktual i NBA-së ka qenë i pezulluar që nga muaji marsi për shkak të përhapjes së virusit Covid-19. ESPN raporton se 12 tetori mund të jetë data e ndeshjes së fundit të këtij sezoni në NBA, përderisa propozimi për formatin dhe kalendarin e ligës pritet të votohet të enjten në bordin drejtues të ligës. Zakonisht,



kampioni i NBA-së vendoset në mes të muajit qershor, mirëpo tashmë sezoni ka ngecur ende me ndeshjeve të mbetura pezull nga

sezoni i rregullt, pa hyrë fare në fazën "play-off"-it. NBA dhe Shoqata e Basketbollistëve në SHBA janë duke diskutuar ende për formatin me të cilin duhet të vazhdojë liga këtë sezon. Komisionari Adam Silver ka propozuar që të bëhet një model i ri me 22 ekipe pjesëmarrëse. Ndërsa, muajin e kaluar NBA-ja bëri të ditur se është në bisedime me kompaninë Walt Disney për t'i zhvilluar të gjitha ndeshjet dhe stërvitjet e mbetura në palestrën e Disney World në Florida, ku edhe të gjithë lojtarët dhe stafi do të strehoheshin në të njëjtin hotel.

SHKURT

Sainz: Nuk kam firmosur me Ferrarin për të qenë pilot i dytë

"Nuk kam firmosur me Ferrarin për të qenë pilot i dytë, pas Leclerc. Në kontratën që kam nënshkruar, ashtu sikurse kam bërë edhe më parë, thuhet se skuadra është mbi pilotin. Ndaj nuk ka asnjë klauzolë që unë ta ndihmoj Leclerc". Ka qenë kjo deklarata e dhënë nga spanjulli Carlos Sainz, që duke nisur nga viti 2021, do të jetë piloti i ri i Ferrarit. Ai ka zënë vendin e Sebastian Vettelit, që do të largohet në fund të këtij viti. "Te Ferrari do ta jap maksimumin tim për të fituar dhe të gjithë në pistë jemi rivalë. Nëse do të ndodhemi përpara një situatë të ndërlikuar, do ta marrim vendimin e duhur", ka thënë Sainz, që këtë sezon do të garojë me McLarenin.

Ter Stegeni: Nuk largohem nga Barcelona

Muajt e fundit është folur shpesh për një krizë të raporteve në mes të Barcelonës dhe portierit gjerman Marc Andre Ter Stegen, por ka qenë vetë ky i fundit, që në një intervistë të dhënë për "Kicker", ka shuar zërat për një largim të mundshëm nga Katalunja. Ai ka deklaruar se ndihet mjaft mirë në "Camp Nou" dhe se prej kohësh ka nisur bisedimet për rinovimin e kontratës me Barcelonën, ndërsa ka pranuar se për momentin negociatat janë ndalur vetëm për shkak të pandemisë. "Te Barcelona kam gjithçka që dua dhe është e sigurt se këtë verë nuk do të largohem. Kemi nisur negociatat për ta rinovuar kontratën, por gjithçka u ndërpre për shkak të pandemisë. Megjithatë, jam i sigurt se do ta gjejmë gjuhën e përbashkët për të vazhduar bashkëpunimin", u shpreh gjermani.

Klopp: Do të organizojmë një festë të madhe, paradë për tifozët tanë

27 fitore në 29 ndeshje dhe 25 pikë më shumë se vendi i dytë. Liverpools ka zhvilluar një kampionat fenomenal dhe fitimi i titullit kampion është çështje kohe. Premierë Liga do të rifillojë më datë 17 qershor dhe kanë mbetur për t'u zhvilluar nëntë javë. Trofeu i madh mungon prej 30 vjetësh në Anfield dhe Jurgen Kloppi e ka mendjen te tifozët. Festa e madhe rrezikohet për shkak të koronavirusit, por trajneri gjerman ka një mesazh për ta në një prononcim për BBC. "Gjithmonë mund të festohet, pavarësisht ku ndodhesh. Nëse shpallemi kampionë, çfarëdo feste të jetë e mundur, ne do ta bëjmë atë. Dhe me të gjithë tifozët tanë kur të na lejohet ta bëjmë përsëri. Nëse ndodh diçka e tillë, premtoj se do të zhvillohet edhe një paradë. Na mjafton një ditë ku të gjithë mund të vijnë për të festuar së bashku", ka thënë Kloppi.

Koronavirusi prek të gjithë ekipin e futbollit, izolohen 25 lojtarë

25 lojtarë dhe stafi i skuadrës ukrainase të Karpaty di Leopoli kanë rezultat pozitivë me koronavirus. Ekipi militon në kategorinë kryesore të kampionatit ukrainas. Lajmin e konfirmoi klubi ukrainas, që ka ftuar edhe klubet e tjera të futbollit të bëjnë edhe ata testet anti-Covid-19, duke i këshilluar të jenë të kujdesshëm. E gjithë skuadra është në izolim. Burime nga klubi bëjnë me dije se shumica e të prekurve nuk kanë simptoma, por janë marrë të gjitha masat për ta garantuar shëndetin e tyre. Të gjitha ndeshjet e Karpaty të programuara për qershorin janë shtyrë pa afat. Kampionati ukrainas ka rinisur fundjavën e kaluar, por ndeshjet janë luajtur pa tifozë.



Republika e Kosovës / Republika kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Lipjanit / Opština Lipjan / Municipality of Lipjan

Në bazë të neneve 5,6,7 dhe 12 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.011-29428 të datës 02.05.2019, nenit 1 të Rregullores Nr.15-345-70953 të datës 31.10.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjeteve taksi 15Nr.011-29428 e datës 02.05.2019 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr.345-4426 të datës 22.01.2020, Drejtorati për Shërbime Publike shpallë:

NJOFTIM PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të lira për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me automjete taksi në Komunën e Lipjanit:

Dy vende në parkingun numër 7 në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari",
Dy vend në parkingun numër 3 të "Shtëpia e Kulturës",
Pesë vende në parkingun numër 4 Rr. "Skënderbeu",
Katër vende në parkingun numër 5 Rr. "Isa Olluri" dhe
Tri vende në parkingun numër 9 Rr. "Xhavit Kozhani".

Operatorët auto taksi duhet të plotësojnë kushtet si në vijim:

- Të jenë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me automjete taksi.
- Të kenë selinë e biznesit në territorin e Komunës së Lipjanit
- Personat fizik të kenë në pronësi automjetin.
- Automjeti duhet të jetë i regjistruar me 5 ulëse (4+1) dhe së paku 4 dyer (nuk pranohet homologimi ose ndryshimi i ulëseve të automjetit)
- Ngjyra e automjeteve taksi mund të jenë të ndryshme me kusht që automjetit ti vendoset një shirit identifikues me ngjyrë bardhë e zi sipas standardeve duke përjashtuar automjetet taksi që operojnë në aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari" të cilat duhet të jenë të ngjyroshme vetëm me ngjyrë të bardhë.
- Drejtuesit e automjeteve të posedojnë patentë shoferin për kategorinë "B" dhe së paku 5 vite përvojë në drejtimin e automjetit, ndërsa të pënjësuarit te personi juridik edhe kontratën e punës.
- Operatorët të cilët operojnë auto taksi në qytetin e Lipjanit duhet të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se viti 2000 ndërsa operatorët të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" duhet të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se viti 2003.
- Përparësi për tu pajisur me licencë në kushte të barabarta do të kenë operatorët të cilët kanë ushtruar veprimtarinë auto taksi.
- Automjetet të cilat e bëjnë djegien me gas nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë auto taksi.
- Të posedojë taksimetrin e vendosur në automjet në gjendje të rregullt, i bazhdaruar nga organi kopetent.
- Të ketë të vendosur mbi kabinë paralel me erëmbrojtësin tabelën me dimensione standarde e paisur për ndriçim natën me shenjën "TAXI"
- Të posedojë aparatën për fikjen e zjarrit.

Operatorët të cilët aplikojnë për marrjen e licencës, aplikacionit duhet ti bashkangjitet dokumentacionin, si vijon:

- Certifikatën mbi regjistrimin e biznesit
- Informatat mbi të dhënat e biznesit
- Fotokopjen e Certifikatës së regjistrimit të automjetit
- Për drejtuesit e automjeteve fotokopjen e patent shoferit për kategorinë "B" ndërsa për të punësuarit edhe kopjen e kontratës së punës
- Vërtetimi nga Policia mbi të kaluarën kriminale të operatorit dhe vozitësit te personat juridik.

Aplikacionet merren në zyrën e Drejtoratit për Shërbime Publike.

Afati i aplikimit është 8 ditë prej datës së publikimit.

Nr. 10-345-20976

Lipjan, datë 03-06-2020

Drejtori i DSHP-së
z. Rasim Hasani



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetska Bolnica I Klinicka Sluzba Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Spitali Përgjithshëm Ferizaj(SPF) - Opsta Bolnica Uroševac(OBU) - Hospital General Ferizaj (HGF)

Drejtorja e spitalit përgjithshëm të Ferizajt, bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dhe neni 4 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neni 5 i Rregullores Nr.1003/2016 mbi marrëdhënien e Punës të SHSKUK-së, si dhe aprovimin fizik të dt.03.03.2020 nga drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK. Me datë 04.03.2020 shpallë këtë:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë Kandidatët Mjekë – specialistët Otorinolaringolog se konkursi i shpallur më datën 05.03.2020

me numër të referencës 1254/20 në Gazetën ditore „Epoka e Re”, vazhdohet **PJESËRISHT** edhe për pesëmbdhjetë (15) ditë kalendarik, nga data: 21.03.2020 deri më datën 04.04.2020 Të gjithë Kandidatët të cilët kanë aplikuar në afat dhe procedure te rregull, nuk kanë nevojë për ri-aplikim.

Drejtor Ekzekutiv

Dr.Jeton Zeqiri

Direktor je zatražio Uroševac, Bazar za 8. zakon o radu br.03 / L-212, za četvrtog administratora i uputstva (MRSZ) br.07 / 2017 za konkursne procedure za svoju sektorsku publiku i za sektor 5 i Uredbom br. 1003/2016 o radnom dokumentu HUCSK-a, kao i fizičko odobrenje od 03.03.2020 od strane generalnog direktora HUCSK-a. Dana 04.03.2020 najavite ovo:

Press

Najavljuju se svi medicinski kandidati - specijalisti otorinolaringolozi i obaveštenje je dano 05.03.2020

sa referentnim brojem 1254/20 u dnevnom novinama „Epoka e Re“, POSEBNO nastavljeno za pedeset (15) kalendara dece, od: 21.03.2020 od 04.04.2020.

Svi kandidati nameravaju da prijave, a ne postupak i redovno, da imaju potrebnu prijavu.

Izvršni direktor

Dr.Jeton Zeqiri

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Valmir Muhadri shpall të pavlefshme certifikatën e furrtares me nr. 302/2015

► Shkëlqim Uka, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së XI, të shkollës "Sami Frashëri" Prishtinë.

► Sueda Guri shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së XI të shkollës "Sami Frashëri" Prishtinë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

